

Atëherë Judë Iskarioti — njëri prej nxënësve të tij, ai që do ta tradhtonte — tha:

»Përse nuk u shit ky parfum për treqind denarë e nuk u shpërnda ndër skamnorë?«

Foli kështu, jo pse ishte fort në kujdes për skamnorë, por pse ishte vjedhës e, mbase ai e mbante qesën, hajnonte nga pak çka qitej brenda.

Po edhe disa nxënës të tjerë e shikonin këtë veprim me pakënaqësi e i thoshnin njëri-tjetrit: »Përse të shkohet dëm ky parfum!« e ia morën për të keq.

E Jezusi tha: »Lëne! Pse po e trazoni! Ajo kreu një vepër të mirë kundrejt meje.

Skamnorët i keni gjithmonë me vete dhe mund t'u bëni mirë kur të doni, përkundrazi, mua nuk do të më keni përherë. Ajo bëri çka mundi: që më narë ma leu trupin tim për varresë. Përnjëmend po ju them: kudo në botën mbarë të predikohet Ungjilli, do të tregohet edhe çka ajo bëri — në përkujtimin e saj.«

Një shumicë hebrenjsh mori vesh se Jezusi gjendej atje e rranë, jo vetëm për shkak të Jezusit, por edhe për të parë Lazrin, të cilin e ngjalli prej së vdekurish. Krerët e priftërinjve vendosën të vrasin edhe Lazrin, sepse për shkak të tij shumë hebrenj i lënin ata e besonin në Jezusin.



Të kryqëzuarit

Të ngjallurit

Të ngriturit në qiell

Hyrja kremtore në Jerusalem

Kur të nesërmen i afruan Jerusalemit dhe arritën në Betfage, në Malin e Ullinjve, atëherë Jezusi dërgoi dy nxënës dhe u tha: »Shkoni në fshat që është kundruall dhe menjëherë do të gjeni aty një gomarë të lidhur me gaçin e saj. Zgjidhne dhe m'i bini! Nëse ndokush u thotë: 'Çka po bëni? Pse po e zgjidhni?' thoni: 'Zotëria po ka nevojë për ta! Por menjëherë do t'i kthejë këtu!'«

Të dërguarit shkuan dhe gjetën ashtu si u kishte thënë Jezusi. E ndërsa ata po e zgjidhin gomarin, i pyetën të zotët e gomarit e do të tjerë që ishin aty: »Pse po e zgjidhni gomarin?«

Ata u thanë: »Zotëria po ka nevojë për të.«

Nuk i penguan,.

Ata bënë ashtu si u tha Jezusi dhe e prunë gomarcën e gaçin e saj te Jezusi, qitën mbi të petkat e veta e Jezusi hypi në të.

E kur ajo shumicë e madhe populli që kishte ardhur në festë, dëgjoi se Jezusi po vinte në Jerusalem, morrën rrema palmash dhe i dolën para.

E kahdo ai kalonte njerëzit i shtrinin udhës petkat e veta. E kur po afrohej të ulet nga shpati i malit të Ullinjve, mbarë turma e nxënësve filloi plot gëzim e me zë të lartë të lavdurojnë Hyun për të gjitha veprat e madhërueshme që kishin parë. E populli që shkante para tij dhe pas tij, brohoriste:

»Hozana të Birit Davidit!

Bekuar qoftë ai që vjen Mbret, në emër të Zotit!

Paqë në qiell! Hozana!

Lavdi në qiejt e lartë!«


Atëherë i thanë disa farisenj që ishin në popull: »Mësues, qortoj nxënësit tu.«

Ai u përgjegji: »Unë po ju them: nëse ata do të heshtojnë, kanë për të bërë gurët!«

Kur iu afrua Jerusalemit, si e pa qytetin, qau mbi të e tha:

»O po ta kuptoshe ti, së paku sot, çka të sjell paqën, por tashti është e fshehur për sy të tu! E kanë për të ardhur në ty ditët, kur armiqtë tu do të rrethojnë me llogore, do të mbajnë të rrethuar e do të ngushtojnë në çdo anë. Kanë për të përplasur për tokë ty e fëmijët tu në ty. Dhe s' kanë për të lënë në ty as gur mbi gur, sepse nuk e njohe kohën e pasisë sate!«

Kur Jezusi hyri në Jerusalem, mbarë qyteti u çua në këmbë dhe pyesnin: »Kush



është ky?« E turma përgjigjte: »Ky është Jezusi, profeti nga Nazareti i Galilesë.«

Jezusi j dëbon tregtarët nga Tempulli

Kështu arritën në Jerusalem. Ai hyri në Tempull e filloi t'i dëbojë të gjithë ata që shitnin e blenin në Tempull. Atyre që



ndërronin të hollat ua përmbysi tavolinat e atyre që shitnin pëllumba ua rrëxoi bankat. Askë nuk lejoi të mbajë ndonjë send nëpër Tempull. I mësonte e u thoshte:

»Po a nuk thotë Shkrimi shenjt: Shtëpia ime do të jetë shtëpi urate për të gjithë popujt e ju e keni bërë shpellë cubash!«

E për çdo ditë mësonte në Tempull.

Kur dëgjuan krerët e priftërinjve e skribët, kërkonin mënyrën se si ta mbytnin; porse e dronin, por asesi s'ia gjenin mënyrën ta kryejnë atë, gjë, sepse mbarë populli, i entuzjazmuar nga mësimi i tij e dëgjonte i rrëmbyer prej fjalëve të tija.

E kur bëhej natë, Jezusi me nxënës dilte nga qyteti. Natën e kalonte në Malin e Ullinjve.

E në mëngjes heret mbarë populli rrante te ai në Tempull për ta ndëgjuar.

Fiku i thatë

Ditën e nesërme dolën prej Betanisë. Ndërsa po shkonin në qytet, Jezusi u

urit. Prej së largu pa një fik me gjethë përngjat udhës. Shkoi nën të për të gjetur ndonjë kokërr fik, e nuk gjeti asgjë, veç gjethë, sepse nuk ishte koha e fiqve. Atëherë i tha fikut: »Askush mos ngrëntë më kurrë kokrra prej teje!«

Nxënësit e tij i ndëgjuan këto fjalë e fiku menjëherë u tha.

Kur të nesërmen, heret në mëngjes, kaluan asajt, panë se fiku ishte tharë me gjithë rrënjë. Nxënësit të çuditur i thanë: »Si mund të thahej ashtu menjëherë fiku?«

Jezusi u përgjegji:

»Kini besim në Hyun! Për të vërtetë po ju them: në paçit fe dhe në mos dyshohet, do të bëni, jo vetëm sa iu bë fikut, por edhe më shumë: nëse ndokush i thotë këtij mali: 'çohu e hidhu në det!' — dhe nuk dyshon në zemrën e vet, por beson se do të ndodhë çka thotë — po, patjetër se ashtu do t'i ngjajë. Prandaj po ju them: Çkado që të kërkonte me uratë, besoni ngultas se e keni marrë, e do ta fitoni me siguri!«

Shembulltyra mbi vreshtarët e këqij

Atëherë zu t'i tregojë popullit këtë shembulltyrë:

»Ishte një zotshtëpie që kishte mbjellë një vreshtë. E thuri me gradh, punoi shtrydhësin e rrushit dhe e ndërtoi kullën. Atëherë ua dha bujqve përgjysmë dhe shkoi në një vend të largët. Kur u afrua koha e të vjelave, dëgroi një shërbëtor te bujqit që t'ia jepnin gjysmën e prodhimit të vreshtës. Por vreshtarët e rrahën dhe e kthyen prapa duarthatë. Pastaj ai dërgoi një shërbëtor tjetër. Por ata edhe atë e rrahën, e poshtuan dhe e nisën prapa me duar zbrazët. Dërgoi edhe të tretin, por ata edhe atë e plagosën dhe e hodhën jashtë e e vranë.

Në fund, i zoti i vreshtës tha: 'Çfarë të bëj?' Kishte vetëm edhe një: djalin e vet të dishirit (të dashurin). U dërgoi pra, birin e vet duke menduar: 'Po u dërgoj djalin tim të dashurin. Së paku për të do të kenë turp!' Porse vreshtarët, kur e panë

djalin, i thanë njëri-tjetrit: 'Ky është trashëgimtari! Ejani ta vrasim e do të na mbesë trashëgimi i tij!' E kapën, e qitën përjashta vreshtës dhe e vranë.

Tashti, kur të vijë i zoti i vreshtës, çka do t'u bëjë këtyre vreshtarë? Do të vijë e do t'i vrasë ata vreshtarë e vreshtën do t'ua japë të tjerëve, të cilët do t'i japin frytin të ardhmën koha e tyre.«

Ata që po e dëgjonin, thanë: »Prite Zot!«

E Jezusi i përshkoi me shikim dhe u tha: »Po çka do të thotë atëherë kjo fjalë e Shkrimit shenjt:

'Guri që e hodhën jashtë përdorimit

ndërtuesit,

erdh e u bë guri i këndit?'

Kushdo të bjerë mbi atë gur do të copëtohet, e mbi kë ai të bjerë do ta dërmojë!«

Kryepriftërinjtë dhe farisenjtë, kur i dëgjuan shembulltyrat e tija, e kuptuan se po fliste për ta. E kërkonin mënyrën si ta zënin, por e dronin popullin, sepse e mbante për profet.

Shembulltyra mbi dasmorin pa petkun e dasmës

Jezusi rishtas vazhdoi t'u flasë në shembulltyra:

»Mbretëria e qiejve është e ngjashme me një mbret, i cili i bëri dasmë të birit të vet. I dërgoi shërbëtorët e vet për t'i grishur të ftuarit në dasmë. Por ata nuk deshën të vijnë. Rishtas dërgoi shërbëtorët tjetër me këto fjalë: 'Thonu të ftuarve: gostinë e kam bërë gati: demat e mi dhe bagëtitë e majme janë prerë, gjithçka është bërë gati: ejani në dasmë!'

Por ata nuk u vunë vesh e shkuan — kush në ara të veta, kush në tregti të vet. Do të tjerë, pastaj, i zunë shërbëtorët e tij, i morën me të keq e i vranë.

Për këtë punë mbreti u zemrua, dërgoi ushtrinë e vet, i vrau ata gjaksorë dhe e dogj qytetin e tyre.

Pastaj u tha shërbëtorëve të vet: 'Dasma njëmend është gati, por të ftuarit nuk qenë të denjë. Dilni, pra, në rrugëkryqe e, gjithsa të gjeni, thirrni në dasmë.'

Shërbëtorët dolën nëpër rruga dhe i prunë të gjithë ata që gjetën: të mirë e të



këqij. Kështu saloni i dasmës u mbush me të ftuar.

Atëherë hyri edhe mbreti për t'i parë të ftuarit. Vuri re njërin që s'e kishte veshur petkun e dasmës. I tha: 'Mik, po si ke hyrë brenda pa pasur petkun e dasmës?' Ai mbeti pa zë. Atëherë mbreti u tha shërbëtorëve: 'Lidhne këmbësh e duarsh dhe flakne përjashta në terr, ku do të jetë vaj dhe kërcëllim dhëmbësh!' Sepse shumë janë të grishur e pak të zgjedhur.«

Tatimi i mbretit

Atëherë farisenjtë u ndanë në njanë anë dhe u këshilluan si ta zënë gabim në fjalë. Ia gjetën rastin dhe dërguan spiunë, nxënësit e vet bashkë me herodianë, të cilët u paraqitnin si njerëz të mirë, vetëm për ta zënë në fjalë e për ta dorëzuar pushtetit dhe autoritetit të qeveritarit. Këta edhe e pyetën:

»Mësues, e dimë se flet të drejtën dhe mëson të vërtetën — ti s' i mban krah askujt, porse mëson udhën e Hyut, pa marrë para sysh se kush është kush, ti nuk kqyrë ç' pozitë kanë njerëzit: na thuj, pra, si e mendon ti: a është e lejueshme t'ia paguajmë Cezarit tatimin, apo jo?«

Jezusi, duke e njohur mirë djallëzinë e tyre, u tha:

»Hipokritë! Përse po më sprovoni? Ma tregoni monedhën e tatimit!«

Ata i prunë një denar.

Ai i pyeti:

»E kujt është kjo fytyrë dhe ky mbishkrim?«

I përgjigjën: »E Cezarit.«

Atëherë u tha:


»Jepni, pra, cezarit, çka i përket cezarit, e Hyut, çka i përket Hyut!«

Kur e dëgjuan përgjigjën, mbetën të habitur. Nuk mund e kapën në fjalë para popullit, por të marrë mendsh prej përgjigjës së tij, heshtuan, dhe e lanë e shkuan.

Dhurata e vejushës së varfër

Pastaj Jezusi ndenj kundruall kasës dhe po vërente si populli hidhte para në kasë; shumë pasanikë, hidhnin shumë. Erdhi gjithashtu një vejushë skamnore edhe ajo qiti dy lepta, dmth. një të katërt të asit — (më e vogla para në qarkullim).

Atëherë Jezusi i thirri nxënësit e vet dhe u tha: »Për të vërtetë po ju them: kjo vejushë skamnore qiti më shumë se të gjithë të tjerët që qitën para në kasë. Sepse, të gjithë qitën prej tepricës, ndërsa kjo qiti prej skamit të vet gjithçka pat: gjithsa pat për jetesën e vet.«



Jezusi e nxënësit e tij

Kur Jezusi po dilte nga Tempulli, i tha njëri nga nxënësit e tij: »Mësues, shiko një herë! Ç' farë gurësh e ç' ndërtesa!«

Jezusi i përgjegji: »A po i sheh gjithkëto ndërtesa të mrekullueshme? Për të vërtetë po u them: do të vijin ditët, ndër të cilat këtu s' do të mbesë asnjëgur pa u rrëzua!«

E kur u ul ndenjor në Malin e Ullinjve, kundruall Tempullit, iu afruan nxënësit Pjetri, Jakobi, Gjoni, Andreu dhe e pyetën vetëm për vetëm:

»Mësues, na trego kur do të ndodhë kjo gjë dhe e cila do të jetë shenja lajmëruese se do të kryhen të gjitha këto? Cila është shenja e ardhjes sate dhe e mbarimit të botës?«

Atëherë Jezusi filloi t'u thotë:

»Veniani mendjen mos t'u gënjejë kusi! Sepse, shumë do të vijin në emër tim dhe do t'u thonë: 'unë jam Krishti!' dhe do të gënjejnë shumëkë. Mos shkoni pas tyre!

E kur të dëgjoni për lufta dhe lajme luftërash, mos u shqetësoni. Njëmend të gjitha këto duhet të ndodhin, por ende nuk është mbarimi.


Do të ngritet një komb kundër një kombi tjetër, një mbretëri kundër një mbretërie tjetër. Do të jenë termete të mëdha të tokës në vende të ndryshme. Do të jenë uri e murtaja, do të ngjajnë dukuri të përfrigueshme e shenja të mëdha nga qielli. E të gjitha këto janë veçse fillësia e vështirësive të tmershme.

Ndër ato ditë do të jetë vështirësi e madhe, sa që e tillë nuk ka qenë që në fillim të botës që Hyu e krijoi deri tani — madje as nuk do të jetë më kurrë. Përmbi tokë do të jetë ngushticë e madhe dhe hidhërim i tmershëm mbi këtë popull. Do të bien të prerë prej tehit të shpatës, do t'i tresin si skllëvër nëpër popuj të ndryshëm. Jerusalemin do ta shklasë këmba e paganëve deri të përmbushet koha e volitshme për paganë. Dhe po mos t'i shkurtonte Zoti ato ditë, asnjë njeri nuk do të mbetëte gjallë. Por, për hir të të zgjedhurve, të cilët ai vet i zgjodhi, Zoti i ka shkurtuar ato ditë.

Mbarimi i botës

Në ato ditë, fill pas aso vështirësie, do të jenë shenja në diell, në hënë e në yje, dielli do të terratiset, hëna nuk do ta japë dritën e vet, yjet do të bien nga qielli. Mbi tokë popujt do të gjenden ngusht, të tmerruar prej gjëmës së detit e të valëve të tija. Shpirti do t'u dalë njerëzve nga frika duke pritur çfarë do të ndodhë me botën sepse trupat qiellorë do të lëkunden.

Atëherë do të duket në qiell shenja e të Birit të njeriut e atëherë do ta shohin të Birin e njeriut duke ardhur mbi re me fuqi të madhe e me madhëri. Do t'i dër-



gojë engjëjt e vet me buri kumbuese për t'i bashkuar të zgjedhurit e tij prej katër anëve të botës, prej skajit të tokës deri në skaj të qiellit — prej njërit skaj të qiellit në tjetrin. Kur të fillojnë të ndodhin të gjitha këto, drejtohuni dhe ngritne kryet

tuaj lart, sepse është ngjat shpërblimi i juaj.

Vëreni fikun dhe lëndët e tjera. Kur bulëzojnë, vetvetiut e dini se vera është afër. Kështu edhe ju, kur të shihni se po ndodhin këto, dinie se Mbretëria e Hyut

është ngjat. Madje mbas dere! Për të vërtetë po ju them, nuk do të kalojë kjo brezni pa ndodhur të gjitha këto. Qielli e toka do të kalojnë, e fjalët e mia nuk do të bien poshtë.

Vëniani mendjen vetes që zemrat tuaja mos të tupiten prej grykësisë, prej çfrenisë e prej kujdeseve të jetës, që mos t' u vijë papritmas ajo ditë, sepse ajo do të vijë pors kurthë mbi të gjithë njerëzit,

Shembulltyra e virgjërave të kujtueshme dhe e virgjërave marroqe

»Atëherë Mbretëria e qiejve do të jetë e ngjashme me dhjetë virgjërat, të cilat i morën dritat e veta dhe i dolën para dhëndrit. Pesë prej tyre ishin marroqe e pesë të kujtueshme. Tashti, këto marroqet, morën me vete dritat, por nuk morën va-



banorët e mbarë vendeve të botës.

Rrini me kujdes! Rrini zgjuar sepse nuk e dini në ç' ditë do të vijë Zotëria juaj. Por mos harroni: po ta dinte i zoti i shtëpisë se në cilën orë të natës i vjen vjedhësi, do të rrinte zgjuar e nuk do të lejonte t'i thehej shtëpia. Prandaj rrini gati, sepse Biri i njeriut do të vijë në atë orë, kur ju s'e prisni.«

jin. Ndërsa ato të kujtueshmet morën me vete dritëzat dhe enët me vaj.

E, pasi u vonua dhëndri, u kotën të gjitha dhe i zu gjumi. Rreth mesnatës u dha lajmi: 'Ja, dhëndri po vjen, dilni para!'

Atëherë u çuan të gjitha vajzat dhe i rregulluan dritat e veta. Atëherë marroqet po u thonë të kujtueshmeve: 'Na jepni prej vajit tuaj se po na ndalen dritat.' E

të kujtueshmet u përgjegjën: 'Që mos të na mungojë neve dhe juve, shkoni më mirë ke tregtarët e bleni për vete.'

Ndërsa ato shkuan të blejnë, erdhi dhëndri e ato që qenë gati, hynë bashkë me të në dasmë dhe dera u mbyll. Njatje vonë, ia behën edhe vajzat e tjera e thanë: 'Zotëri, o zotëri, na e çel derën!' Por ai u përgjegji: 'Përnjëmend po ju them: unë nuk u njoh.'

rit i dha pesë talenta, një tjetri dy e të tretit vetëm një: secilit sipas zotësisë së tij dhe fill pas u nis. U çua, tashti, ai që mori pesë talenta, i shtiu në punë dhe me ta i fitoi edhe pesë të tjerë. Gjithashtu bëri edhe ai që mori dy talenta. Ndërsa ai që mori vetëm një, shkoi, e çeli një gropë në dhe, dhe e fshehi paranë e zotërisë së vet.

Pas një kohe së gjatë u kthye zotëria



Prandaj rrini zgjuar, sepse nuk e dini ditën as orën!«

Shembulltyra me talenta

»Do të ngajë, pra, si me atë njeriun, që u nis për rrugë: i thirri shërbëtorët e vet dhe ua dorëzoi pasuritë e veta. Një-

i atyre shërbëtorëve dhe kërkoi llogari prej tyre. E si doli para ai që kishte pasë marrë pesë talenta, i qiti para edhe pesë talenta të tjerë e tha: 'Zotëri, ti më pate dhënë pesë talenta, ja, edhe pesë të tjerë që i kam fituar.' I përgjegji zotëria i tij: 'Të lumtë, shërbëtor i mirë e besnik, pse je dëftuar besnik në gjëra të vogla, do të bëj të parë mbi pasuri të mëdha: hyr në gë-

zimin e zotërisë tend!' (Ç' shpërblim!).

U afrua pastaj edhe ai që kishte marrë dy talenta dhe tha: 'Zotëri, ti më pate dhënë dy talenta, ja, edhe dy të tjerë që i kam fituar.' I përgjegji zotëria: 'Të lumtë, shërbëtor i mirë e besnik! Pse je treguar besnik në sende të vogla, do të bëj të parë mbi gjëra të mëdha: hyr në gëzimin e zotërisë tënd!'

Kur u afrua ai që kishte pasë marrë vetëm një talent, tha: 'Zotëri, duke të njohur se je njeri i ashpër, se korr ku nuk ke mbjellë e mbledh ku nuk ke shpërndarë, u tuta dhe e fsheha në dhe talentin tënd: ja, tani gjënë tënde!'

Zotëria i tij i përgjegji me këto fjalë: 'Shërbëtor i keq dhe përtac! E paske ditur se korri ku s'kam mbjellë e mbledh ku nuk kam shpërndarë, prandaj edhe të është dashur ta shtish paranë time në bankë e në kthimin tim unë kisha marrë kryet e gjësë dhe kamatën. Prandaj, merrne prej tij talentin e jepjani atij që ka dhjetë talenta! Sepse, atij që ka do t'i jepet më e do të ketë me shumicë, e atij që s' ka do t'i merret edhe ajo pakicë që ka! E shërbëtorin e pavlefshëm hidhne në errësirë, ku do të jetë vaj dhe kërcëllim dhëmbësh!«

Dita e gjyqit

»Kur të vijë Biri i njeriut me madhërinë e vet e i përcjellë prej të gjithë engjëjve të vet, atëherë do të ulet mbi fronin e lavdisë së vet. Pastaj para tij do të mbli-dhen të gjithë popujt dhe ai do t'i ndajë njerin prej tjetrit, sikurse bariu i ndan delet prej cjepeve. Delet do t'i vërë në e djathtë e vet e cjeptë në e majtë e vet.

Atëherë mbreti do t'u thotë atyre që janë në të djathtë e tij: 'Ejani të bekuarit e Atit tim, trashëgoni Mbretërinë që është bërë gati për ju që prej fillimit të botës! Sepse, pata uri e më dhatë të ha, pata et e më dhatë të pi, isha shtegtar e më përbujtët, isha i zhveshur e më veshët, i sëmurë e erdhët të më shihni, isha në burg e erdhët te unë.'

Të drejtit atëherë do të përgjegjin: 'Zot, kur të pamë të unshëm e të dhamë të ngrënësh, të etshëm e të dhamë të pish? Kur të pamë shtegtar e të kemi përbujtur,



të zhveshur e të kemi veshur? Ose, kur të sëmurë e në burg e kemi ardhur te ti?' Mbreti do t'u përgjegjë: 'Për të vërtetë po ju them: sa i keni bërë njerit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, ma keni bërë mua.'

Atëherë do t'u thotë edhe atyre në të majtën: 'Ikni prej meje, të mallkuar, në zjarr të pasosur që është bërë gati për djallin dhe për engjëjt e tij! Sepse, isha i unshëm e nuk më dhatë të ha, isha etshëm e nuk më dhatë të pi, isha shtegtar e nuk më përbujtët, isha zhveshur e nuk më veshët, i sëmurë dhe në burg e nuk erdhët ke unë.'

Atëherë edhe ata do t'i përgjegjin: 'O Zot, e kur të pamë unshëm, a të etshëm, a shtegtar, a të zhveshur, o të sëmurë, o në burg e nuk t'u gjetëm në nevojë?' E ai do t'u përgjegjë me këto fjalë: 'Për të vërtetë po ju them: sa s'i keni bërë njerit prej këtyre më të vegjëleve, s' ma keni bërë mua!' Këta do të shkojnë në mundim të përhershëm e të drejtit në jetën e pasosur.«


Juda dëshiron ta tradhtojë Jezusin

Mbas dy ditëve do të ishin Pashkët dhe ditët e Bukëve të pabruara. E Jezusi, pasi i i kreu të gjitha këto fjalime, u tha nxënësve të vet: »Ju e dini se edhe dy ditë janë Pashkët dhe Biri i njeriut do të dorëzohet për të qenë kryqëzuar.«

Ndërkaq kryepiftërinjtë dhe pleqtë e popullit u bashkuan në këshillim në pallatin kryepiftit që quhej Kajfa dhe prunë vendimin ta zënë Jezusin me tradhti dhe ta vrasin. Por thoshnin: »Jo në ditë feste që mos të bëhet ndonjë trazirë në popull.«

E djalli hyri në Judën, që quhej Iskariot e ishte një nga numri i të Dymbëdhjetëve. Ai shkoj dhe bëri godi me krerët e piftërinjve dhe me policinë e Tempullit si t'ua shtinte në dorë. Tha: »Çka po më jepni e unë po jua shtie në dorë?«

Ata kur dëgjuan, u gëzuan dhe i prem-tuan të holla. I caktuan tridhjetë sikla të argjenta. Juda pranoi. Që atëherë kërkonte rast të volitshëm për t'ua dorëzuar kur mos të ishte populli pranë.



Darka e fundit

Ditën e parë të festës së Bukëve të Pabruara, kur slijohej qengji i Pashkëve, nxënësit i thanë Jezusit:

»Ku dëshiron të shkojmë të bëjmë gati darkën e Pashkëve?«

Atëherë Jezusi i dërgoi dy prej nxënë-

sve të vet — dhe u tha: »Shkoni në qytet e do t'ju takojë një njeri me enë uji në dorë. Shkoni pas tij në shtëpi. Zotshëpisë ku ai të hyjë, thoni: 'Mësuesi thotë: ku është saloni, në të cilin do të ngëni pashkët me nxënësit e mi. Dhe ai do t'u tregojë në kat një salon të madh, të shtruar e të përgatitur. Aty na e bëni

gati darkën.« (*Aty themeloi Eukaristinë*).

Nxënësit u nisën, arritën në qytet, gjetën ashtu si u kishte thënë Jezusi dhe e bënë gati darkën e pashkëve.

Kur u bë natë Jezusi erdhi me të Dymbëdhjetit. E kur erdhi koha e bukës, Jezusi u ul në tryezë e bashkë me të edhe apostujt.

Atëherë u tha:

»Me gjithë shpirt kam dëshiruar ta ha këtë darkë të pashkëve bashkë me ju para se të pësoj. Me të vërtetë po ju them: nuk do të ngrëni më para se të plotësohet në Mbretërinë e Hyut.«

Në kohën e darkës, Jezusi Zot, atë natë kur qe tradhtuar, mori bukën, u falënderua

(Hyut), e theu dhe ua dha nxënësve të vet e tha: Merrni e hani! Ky është Korpi im i flijuar për ju. Bëni këtë në përkujtimin tim!»

Gjithastu pas darkës, mori kelkun, u fëllënderua dhe ua dha e tha: »Pini prej tij të gjithë! — sepse ky është Gjaku im i Besëlidhjes së re i derdhur për ju në shpërbllim të mëkateve. Sa herë që të pini, bënie këtë në përkujtimin tim!«

Dhe të gjithë pinë nga kelku.

Në kohë të darkës, mbasi djalli ia kishte vënë në zemër Judës, të birit të Simonit

Iskariot, vendimin ta tradhtojë, — Jezusi që e dinte se Ati i ka lëshuar gjithçka në dorë dhe se ka dalë prej Hyut e se po kthente te Hyu — u ngrit nga darka, hoq petkun e sipërm, mori një peshqir dhe u ngjesh. Qiti ujë në legen dhe filloi t'ua lajë këmbët nxënësve e t'ua fshijë me peshqir, me të cilin ishte ngjeshur.

Arriti kështu te Simon Pjetri. Ai i tha: »Zotëri, ti të më lash këmbët?!«

Jezusi i përgjegji: »Çka unë po bëj, ti tani nuk e kupton. Do ta kuptosh më vonë.«

Pjetri i përgjegji: »Nuk do të m'i lash këmbët kurrë e për këtë jetë!«

Jezusi i tha: »Nëse nuk do t'i laj, nuk do të kesh pjesë me mua.«

Simon Pjetri i përgjegji: »Atëherë, Zotëri, jo veç këmbët e mia, por edhe duart, edhe kryet!«

Jezusi i tha »Kush është i larë, nuk i duhet të lajë tjetër posë këmbët — dhe është krejtësisht i pastër. Edhe ju jeni të pastër, por jo të gjithë.«

Sepse e dinte kush do ta tradhtojë, postafat tha: »Nuk jeni të gjithë të pastër.«

Bëni sikurse unë bëra për ju

Pasi ua lau këmbët, mori petkat e veta, u ul rishtas në tryezë e u tha: »A e merrni vesh çka kam bërë? Ju më quani Mësues e Zotëri. Mirë thoni se unë me të vërtetë jam. Nëse, pra, unë, Zotëri dhe mësues — ua lava këmbët, e keni për detyrë edhe ju t'ia lani këmbët njëri-tjetrit. U kam dhënë shembull, që, sikurse ju bëra unë juve, të bëni edhe ju. Përnjëmend, përnjëmend po ju them: nuk është shërbëtori më i madh se zotëria i tij, as i dërguari më i madh se ai që e ka dërguar. Të lumtë ju nëse i kuptoni këto gjëra dhe nëse i zbatoni!«

Jezusi e zbulon tradhtarin e vet

»Nuk flas për të gjithë ju! Unë di kë kam zgjedhur. Por — le të shkojë në vend Shkrimi shenjt:

'Ai që ngrën bukën time, kundër meje e ka ngritur thembrën.'

Si tha kështu, Jezusi i tronditur thell në shpirt, shpalli:

»Përnjëmend, përnjëmend po ju them: njëri prej jush — njai që ngrën me mua — do të më tradhtojë.«

Atëherë nxënësit e kqyrën njëri-tjetrin sepse nuk dinin për të cilin fliste. Njëri prej nxënësish — ai, të cilin Jezusi e donte veçanërisht — ishte në tryezë përngjat parzmës së Jezusit. Atëherë Simon Pjetri i bëri shenjë e i tha: »Pyete kush është ai për të cilin thotë!« Ky atëherë iu mbështet Jezusit në parzëm dhe e pyeti: »Zotëri, kush është ai?«

Jezusi përgjegji: »Ai është, të cilit unë po i jap kafshatën e ngjyer.«

Atëherë e ngjeu kafshatën, e mori dhe ia dha Judës së Simon Iskariotit. Pas aso kafshate djalli hyri në të.

Jezusi i tha: »Ç' ke në mend të bësh, bëje shpejt!«

Askush prej atyre që ishin në tryezë nuk e mori vesh pse i tha ashtu. Por, mbasi Juda mbante qesën, disa menduan se Jezusi i kishte thënë: »Na blej çka na lypet për festë.« — ose t'u japë ndonjë send skamnorëve.

Juda, posa e mori kafshatën, menjëherë doli jashtë. E ishte natë.



Lamtumira e fundit prej nxënësve

Kur Juda doli përjashta, Jezusi tha:
»Tani është lavduruar Biri i njeriut!
Po edhe Hyu është lavduruar në të! Hyu
është lavduruar në të, edhe Hyu do t'i
japë Birit lavdi! Po! Menjëherë do ta
lumturojë.

Fëmijëzit e mi! Edhe pak kohë jam me
ju! Ju do të më kërkoni, por, sikurse u
thashë edhe hebrenjve, tani po ju them edhe
juve: ku unë shkoj, ju nuk mund të vini. Po
ju jap një urdhër të ri: duane njëri-tjet-
trin! Sikurse unë u kam dashur ju, ashtu
edhe ju duane njëri-tjetrin. Në këtë gjë
do t'ju njohin se jeni nxënësit e mi nëse
do ta doni njëri-tjetrin.

Askush s' ka dashuri më të madhe se
këtë, në qoftë se ndokush e jep jetën
e vet për dashamirët e vet. Ju jeni dasha-
mirët e mi në qoftë se bëni çka unë
urdhëroj. Nuk ju thërras më shërbëtorë,
sepse shërbëtori nuk di çka bën zotëria
i tij. Unë u quaj miq, sepse u zbulova
gjithçka kam ndëgjuar prej Atit tim.

Simon Pjetri e pyeti:

»Zotëri, ku mendon ashtu të shkosh?«

Jezusi i përgjegji:

»Ku unë mendoj të shkoj, ti tani për tani
s'mund të vish; por më vonë do të vish.«

Atëherë Pjetri i tha: »Zotëri, e pse tani
nuk mund të vij pas teje? Unë do ta jap
jetën time për ty!«

Jezusi i përgjegji: »Ti do ta jepësh jetën

për mua?! Përnjëmend, përnjëmend po të
them: nuk do të këndoje gjeli para se të
më mohosh tri herë! E të gjithë ju sonde do
të shkandulloheni në mua sepse thotë Shkri-
mi shenjt: *Do t'i bie bariut e dhentë e
tufës do të shpërndahen!* Por, kur të ngja-
llem, do të shkoj para jush në Galile.«

Atëherë Jezusi u tha:

»Kur u dërgova pa qese, pa strajcë e
pa të mbathura, a u ka munguar gjë?«


Ata i përgjegji: »Asgjë!«

Atëherë u tha: »Por tani — kush ka
qese, le ta marrë! Po ashtu edhe strajcën!
E kush s' ka, le t'i shesë petkat e veta
e le të blejë shpatën; sepse po ju them du-
het të vërtetohet në mua — fjala e Shkri-
mit shenjt: 'u numrua ndër bëmëqij!' Për
të vërtetë, gjithçka është parafolur për mua,
po plotësohet.«

Ata i thanë: »Zotëri, ja, këtu dy shpata!«

Ai u përgjegji: »Mjaftojnë!«

»Mos të shqetësohet zemra juaj! Be-
soni në Hyun! Edhe në mua besoni! Në
shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa. Po
mos të kishte, a do t'u thoja: po shkoj
t'ua bëj gati vendin? Kur të shkoj e t'ua
bëj gati vendin, rishtas do të vij e do t'ju
marr te unë, që të jeni edhe ju aty ku
gjendem unë.«



Në kopshtin e Gjetsemanit

E pasi e kënduan këngën e falën-
derjes, Jezusi kaloi bashkë me nxënësit e
vet m'atë anë të përroit Cedron dhe u nis,
sipas dokës, drejt Malit të Ullinjve në
kopshtin që quhet Gëtsemani e hyri në
të ai e nxënësit e tij. Atëherë u tha nxë-
nësve: »Rrini këtu sa të shkoj unë e të
lutem. Lutuni mos të bini në tundim!«

Me vete mori Pjetrin e dy të bijtë e
Zebedeut, Jakobin e Gjonin e filloi të
trishtohet, ta kapë frika e të dridhej prej
tutës. U tha:

»Shpirti im është i trishtuar deri në vdekje,
mos u largoni e rrini zgjuar!«

Jezusi lutet

U largua sa mund të qitet pesha, ra në
gjunj, me fytyrë për dhe e filloi të lutet,
që — nëse është e mundur — të shpë-
tojë pa e sprovuar atë orë. Thoshte:
»Abba! Atë! Ti mund të bësh gjithçka!

Nëse do, largoje prej meje këtë gotë!
Veçse le të bëhet, jo vullnesa ime, por e
jotja!«

U kthye ke nxënësit e i gjet duke
fjetur. I tha Pjetrit:

»Simon! A po fle? Si kështu! A nuk
mundët të rrini zgjuar me mua as për një
orë të vetme? Rrini zgjuar e lutuni të
mos bini në tundim! Shpirti njëmend është
i gatshëm, por trupi është i ligshhtë.«


Rishtas shkoi të dytën herë e u lut duke
përsëritur të njëjtat fjalë: »Ati im! Nëse
s'mund të kalojë ky kelk pa u pi prej meje,
u bëftë vullnesa jote!«

Prap u kthye e rishtas i gjeti fjetur:
sytë ua kishte rënduar gjumi. E nuk dinin
çka t'i përgjegjinin. I la, përsëri u kthye
e u lut edhe të tretën herë duke thënë
të njëjtat fjalë.

Atëherë iu duk engjëlli prej qiellit dhe
i dha zemër. E kur e kapën dhimbjet
e vdekjes, lutej edhe më fort e djersa e
tij e bë si pika gjaku të trasha që i binin
për tokë.

Atëherë u ngrit nga urata e për të
tretën herë erdhi te nxënësit e i gjeti
fjetur, të kputur prej trishtimit. U tha:

»Ende fleni e pushoni? Mjaft më! Arriti
ora! Ja, Biri i njeriut po lëshohet në duar



të mëkatnorëve! Ngrituni të shkojmë! Ja, po afrohet ai që po më tradhton!»

Jezusin e arrestojnë

Edhe Juda, tradhtari i tij e dinte atë vend, sepse Jezusi shpeshherë bashkohej atje me nxënësit e vet. Atëherë Juda mori prej krerëve të priftërinjve e prej farisenjve togën dhe rojëtarët e Tempullit e ia behi atje me pisha të ndezura, me dritëza e me armë, me shpata e me shkopinj. Tradhtari i tij u kishte dhënë këtë shenjë:

»Kë unë (të marr ngryk) të puthi, ai është. Atë kapnie e merrne me vete me kujdes të madh.«

Ndërsa Jezusi ende po fliste, qe ia behi turma e, në krye të saj, ai që quhet Judë, njëri prej të Dymbëdhjetëve. Ai menjëherë iu afrua Jezusit për ta puthur. I tha:

»Të falem, Mësues!« Dhe e puthi.

Jezusi i tha:

»Mik, e di pse ke ardhur! O Judë, a me të puthur po e tradhton të Birin e njeriut!«

Atëherë ata u afruan, vunë dorë në Jezusin dhe e arrestuan. E ata që ishin për rreth tij, kur panë se ç' po ngjan, thanë: »Zotëri, a u sjellim shpatë?« Dhe, ja, njëri

prej atyre që ishin me Jezusin, Simon Pjetri, që e kishte shpatën, çoi dorën, nxori shpatën e vet dhe i ra shërbëtorit të kryepriestit dhe ia preu veshin e djathtë. Shërbëtori e kishte emrin Malk.

Jezusi foli: »Zini vend! Mjaft!«

Ia preku veshin dhe ia shëroi. Atëherë i tha Pjetrit:

»Ktheje shpatën tënde në vend të vet! Sepse të gjithë ata që kapën për shpatë, prej shpatës edhe do të vdesin. A ndoshta ti kujton se unë nuk mund t'i lutem Atit tim dhe se Ai nuk kishte për të m'i dërguar menjëherë dymbëdhjetë legjione engjëjsh? Mirë, po, si kishin për t'u plotësuar atëherë fjalët e Shkrimit shenjt, pas të cilave duhet të ndodhë kështu? A mos ta pi gotën që ma dha Ati?«

Atëherë Jezusi iu drejtua turmës: »Keni dalë të më zëni me shpata e me shkopinj si të isha unë cub; e pra, për ditë kam ndenjur me ju në Tempull duke mësuar e nuk më keni zënë. Porse kjo është ora juaj dhe pushteti i territ.«

E të gjitha këto ndodhën që të shkonin në vend shkrimit e profetëve.

Atëherë të gjithë nxënësit e lanë e ikën.

E çuan më së pari ke Ana e Ana e dërgoi të lidhur te Kryepriestit, Kajfa, ku ishin bashkuar krerët e priftërinjve, skribët

e pleqtë. Krerët e priftërinjve dhe mbarë Këshili i lartë kërkonin dëshmi në rrenë kundër Jezusit për ta vrarë. Por nuk gjetën edhe pse u paraqitën shumë dëshmitarë në rrenë. Në fund u paraqitën dy dishmitarë në rrenë kundër tij që thanë: »Ne e kemi dëgjuar duke thënë: 'Unë do ta rrenoj këtë Tempull — të punuar me dorë njeriu dhe në tri ditë do ta punoj një tjetër që s'do të jetë i punuar me dorë.'«

Por dëshmia e tyre as në këtë pikë nuk ishte në përkim.

Atëherë u ngrit kryepriestit dhe i tha:

»Ti s'po përgjegj asgjë për sa këta po dëshmojnë kundër teje?«

Por Jezusi heshtonte.

Kryepriestit i tha:

»Po të përbej pashë Hyun e gjallë, na thuaj a je ti Krishti, Biri i Hyut?«

Jezusi i përgjegji:

»Po, unë jam! Madje unë po ju them: edhe pak kohë e ju do ta shihni të Birin e njeriut duke ndenjur në të djathtën e të Gjithpushtetshmit e duke ardhur mbi retë e qiellit.«

Atëherë kryepriestit i shqeu petkat e veta e tha:

»Ka sharë Hyun! Ç'nevojë kemi më për dëshmitarë! Ja, pra, ju vetë e dëgjuat blasfeminë! Çka u duket?«

Të gjithë përgjegjën:

»Meriton të vdesë!«

Atëherë disa ia filluan ta pështyejnë, t'ia mbulojnë fytyrën, t'i bien grushta e flakaresha. E ata që e ruanin e përqeshnin dhe e rrihnin, ia mbulonin fytyrën dhe i thoshnin: »Na trego kush të ra?« Dhe thoshnin edhe shumë blasfemje të tjera kundër tij.

Pjetri i bie mohit Jezusit

Përmbas Jezusit shkonin, duke e ndjekur prej së largu deri në oborr të kryepriestit, Simon Pjetri e ai nxënësi tjetër. Ai nxënësi tjetër njihej me kryepriestit dhe me Jezusin hyri në oborr të kryepriestit, ndërsa Pjetri mbeti përjashta, te dera. Atëherë ai nxënësi tjetër, që ishte i njohur me kryepriestit, doli, foli me dertaren dhe e shtiu Pjetrin brenda. Ndërkaq shërbëtorja dertare i tha Pjetrit: »A mos je edhe ti prej nxënësish të atij njeriu?«

Ky përgjegji: »Nuk jam.« Dhe hyri brenda e ndenj me shërbëtorë për të parë si do të merrte fund puna. Aty ishin shërbëtorë e rojëtarë: kishin ndezur zjarr e po nxeheshin se bënte të ftohtë. Me ta rrinte Pjetri e po nxehej. I thanë, pra: »A mos je edhe ti prej nxënësve të tij?«

Ai mohoi e tha: »Nuk jam!«

Dhe, pas një ore, një tjetër tha: »Me të vërtetë, edhe ky ishte me të! Jo po, ky është edhe galileas!«

E Pjetri tha: »S'di ç'po thua, bre burrë!«

Dhe shi atëherë, ndërsa ende po fliste — gjeli këndoi të dytën herë. E Zoti u suall, ia lëshoi sytë Pjetrit. Atëherë Pjetrit i ra ndër mend fjala e Zotit që ia pati thënë: »Para se sot të këndoje gjeli dy herë, do të më mohosh tri herë.« Doli përjashta e qau thekshëm.

Juda vret veten

Atëherë Juda, ai që e kishte tradhtuar, kur pa se e dënuan Jezusin, i brejtur



nga ndërgjegjia, ua ktheu kryepriestërinjve e pleqve të popullit tridhjetë siklat e argjenta e u tha: »Mëkatnova duke tradhtuar gjakun e pafajshëm!«

Ata i përgjegjën: »Çka na duhet neve? Është punë për ty!«

Juda i hodhi siklat e argjenta në Tempull, u largua andej dhe shkoi e u varë.

Kryepriestërinjtë i mblodhën siklat e argjenta e thanë:

»Nuk guxohet të shtihen në kasë të Tempullit, sepse janë çmim gjaku.«

Dhe, pasi u këshilluan, blenë me ato të holla arën e një vorbëtarë për varreza të shtegtarëve. Këndeje edhe ajo arë u quajt deri më sot: 'ara e gjakut'. Atëherë shkoi në vend fjala e Jeremisë profet që thotë: »Morën tridhjetë sikla argjendi, çmimin e të Çmuarit, të cilin e çmuuan të bijtë e Izraelit dhe e shpenzuan për arën e vorbëtarit, sikurse më urdhëroi vetë Zoti.«

Jezusin e qesin para Pilatit

Atëherë e çuan Jezusin prej Kajfës në pretorium — pallatin e qeveritarit. Ishte heret në mëngjes. Jezusin e qitën para qeveritarit. Ata nuk hynë brenda, që mos të përlyheshin, por të mund të hanin darkën e pashkëve.

Këndeje Pilati doli jashtë para tyre dhe i pyeti:

»Çfarë padie keni kundër këtij njeriu?«

I përgjegjën:

»Po mos të ishte ky bëkeq, nuk do ta kishin prurë para teje!«

Pilati u tha:

»Merrne ju dhe gjykone sipas Ligjit tuaj.«

I përgjegjën:

»Ne s'kemi leje të dënojmë ndokë për vdekje.«

Ngjau kështu që të shkonte në vend fjala e Jezusit, me të cilën parafoli se me ç' vdekje do të vdiste.

Atëherë zunë ta padisin:

»E gjetëm duke nxitur popullin tonë në kryengritje, ndalon të paguhet tatimi Cezarit e për vete thotë se është Mesia mbret.«

Atëherë Pilati hyri rishtas në zyrë, e thirri Jezusin dhe e pyeti:

»A je ti mbreti i hebrenjve?«

Jezusi i përgjegjji:

»A e thua ti prej vetevetes këtë, apor ta thanë të tjerët për mua?«

Pilati përgjegjji:

»Pse, a jam unë çifut? Populli yt dhe kryepfiftërinjtë të kanë dorëzuar mua. Çka ke bërë?«

Jezusi përgjegjji:

»Mbretëria ime nuk është e kësaj bote. Po të ishte mbretëria ime e kësaj bote, shërbëtorët e mi do të kishin luftuar që mos të bija në duar të çifutëve. Porse

Mbretëria ime nuk është prej këndeje.«

Prandaj Pilati i tha:

»Pra, ti qenke mbret?«

Jezusi përgjegjji:

»Po, mirë thua! Unë jam mbret!«

E unë kam lindur dhe kam ardhur në botë për të dëshmuar të vërtetën. Kush e do të vërtetën, ai e dëgjon fjalën time.«

Pilati i tha:

»Po, çka është e vërteta!?«

Pilati përkulet para çifutëve

Si foli kështu, rishtas doli jashtë para hebrenjve dhe u deklaroi: »Unë nuk gjej në të kurrfarë faji.«

Tashti, për çdo të kremte, qeveritari e kishte doke t'i falë popullit atë të burgosur që populli donte. Aso here ishte i burgosur një njeri i përmendur për të keq, që quhej Barabë, i burgosur me kryengritës të tjerë, të cilët kishin bërë vrasje. Gjindja u ngjitën lart e filluan të kërkojnë prej Pilatit të bëjë si e kishte doke për festë.

A tyre, pra, që u mblodhën, Pilati u tha:

»Cilin dëshironi t'u liroj: Barabën apo Jezusin, që quhet Krisht?«

E dinte mirë se ia kishin dorëzuar Jezusin pse ia kishin smirë.

Tashti, ndërkohë që qeveritari ishte në gjykatore, gruaja e tij i çoi fjalë:

»Kurrësesi mos u përzij në çështje të atij të drejti, sepse sonte kam pësuar shumë në ëndërr për shkak të tij.«

Porse krerët e piftërinjve dhe pleqtë e nxitën popullin të kërkojnë t'ua lëshojë Barabën e Jezusin ta dënojnë për vdekje.

Atëherë qeveritari i pyeti:

»Cilin ndër këta të dy doni t'ua liroj?«


Por mbarë turma zu të bërtasë: »Këtë vraje e na liro Barabën!«

Pilati foli rishtas sepse dëshironte ta lirojë Jezusin; tha: »Çka doni të bëj me atë që ju thoni se është mbreti i hebrenjve?«

Ata bërtitën rishtas: »Kryqëzoje, kryqëzoje!«

Pilati u tha për të tretën herë: »Po çfarë të keqeje ka bërë? Nuk gjeta në të faj që të meritojë vdekjen.«

Porse ata bërtisnin me sa zë kishin përherë e më fort e kërkonin ta kryqëzojë. Brima e tyre shkonte gjithnjë dukë u shtuar.



Atëherë Pilati, duke dashur të kënaqë turmën, vendosi të bëhet ashtu si ata kërkonin. U lëshoi atë që kërkuan, që pat qenë burgosur për shkak të kryengritjes e të vrasës.

Ushtarët e shtinë Jezusin brenda në oborr — dhe e bashkuan rreth tij mbarë togën. E zhveshën e atëherë e mbështollën me një mantel të kuq e në krye i vunë një kurorë të gërshetuar me therra, ndërsa në dorë i dhanë një kallam. Afroheshin përngjat tij, binin në gjunj para tij për

Jezusin e kryqëzojnë

Pasi e vunë në lojë, ia hoqën mantelin e kuq, e veshën me petkat e tija dhe e çuan për ta kryqëzuar. E ndërsa po ngjiteshin, takuan në një njeri nga Cirena, me emër Simon. Këtë e shtërnguan ta mbante kryqin e tij.

Pas tij shkante një shumicë e madhe njerëzish, sidomos grashë, të cilat e qanin



ta vënë në lojë. Zunë ta përshëndetnin: »Të falemi, mbreti i hebrenjve!« Dhe i binin paravesha. Pështynin mbi të, ia morën kallamin dhe me të i binin kresë.

Kur Pilati pa se s'po arrinte asgjë, dhe se pështjellimi shkante gjithnjë duke u shtuar, mori ujë dhe, në sy të popullit, i lau duart duke thënë:

»Unë jam i pafajshëm në gjak të këtij të drejti; e hjekshit ju!«

Mbarë populli përgjegji: »Gjaku i tij raftë mbi ne dhe mbi fëmijët tanë!«

Atëherë ua dorëzoi ta kryqëzojnë.

dhe e vajtonin. Jezusi e suall prej tyre e u tha:

»Bijat e Jerusalemit, mos qani mua, por qani veten dhe fëmijët tuaj. Sepse, ja, po vjen koha, kur do të thuhet: 'Lum beronjat dhe krahërorët që nuk lindën! Lum gjithë që nuk dhanë të pijnë!' Atëherë do të fillohet të luten malet: Bini mbi ne! E kodrat: Na mbuloni! Sepse — në qoftë se bëhet kështu me drurin e njomë, çka do të ndodhë me të thatin?«

Sillinin me të edhe dy të tjerë — bëkëqij, për t'i vrrarë bashkë me të.

E çuan në vend që quhet Gólgota — që domethanë »vendi i kafkës«. Atëherë e kryqëzuan. Bashkë me të kryqëzuan edhe dy cuba — njërin në të djathtën e të tjetrin në të majtën e tij. Kështu shkoi në vend fjala e Shkrimit shenjt: 'U numrua ndër bëkëqijtë.'

Ishte ora tre kur e kryqëzuan.

Jezusi thoshte: »Fali, o Atë, se nuk dinë çka bëjnë.«

E Pilati e shkroi mbishkrimin e fajësisë dhe e vuri në kryq mbi krye të Jezusit.

pjesë — secilit ushtar nga një pjesë. Morën edhe petkun e poshtëm. Ai nuk ishte i qepur me pola, por i punuar një cope — prej në maje e deri në fund. Prandaj i thanë njëri-tjetrit: »Nuk po e ndajmë në pjesë, por po qesim short kujt t'i bjerë.«

Ndodhi kështu që të shkojë në vend fjala e Shkrimit shenjt: 'I ndanë ndër vete petkat e mia e mbi petkun tim qitën short.'

Ushtarët bënë shi ashtu.



Skruante:

»Ky është Jezu Nazareni, mbreti i judenjve.«

Këtë mbishkrim e lexuan shumë hebrenj, sepse vendi ku e kryqëzuan Jezusin ishte ngjat qytetit. Ishte i shkruar hebraisht, latinisht e greqish.

I ndanë petkat e tija


Ushtarët, pasi e kryqëzuan Jezusin, i morën petkat e tija dhe i ndanë në katër

Populli e vë në lojë Jezusin

Populli rrinte aty e kundronte, ndërsa kalimtarët e shanin duke luajtur me kokë në shpoti e thoshnin: »Ti që e rrenon Tempullin e në tri ditë e rindërton, shpëto vetveten! Në qoftë se je Biri i Hyut, zbrit nga kryqi!«

Po ashtu e përqeshnin edhe kryepfëtrinjtë bashkë me skribë e me pleq duke i thënë njëri-tjetrit:

»Të tjerët i shpëtoi, por vetveten s'mund ta shpëtojë! Krishti, Mbret i Izraelit! Le



të ulet tani prej kryqit, ta shohim e të besojmë! Le ta shpëtojë vetveten, nëse njëmend është Mesia, i Zgjedhuri i Hyut! Ka shpresuar në Hyun, le ta lirojë tani, nëse përnjëmend e do! Jo po, ai vetë tha: 'Jam Biri i Hyut!'

Njëri nga ata dy bëkëqijtë e varur e shante:

»Po a nuk je ti Mesia?! Shpëto veten edhe ne!«

Ai tjetri e qortoi këtë dhe i tha:

»Po a nuk e dron Hyun as ti që je në

të njëjtin dënim me të? E ne veç, me të drejtë, se po marrim shpërblimin e merituar për veprat tona, por ky — s'ka bërë kurrgjë të keqe!«

Atëherë iu drejtua Jezusit:

»Të bie ndër mend për mua, o Jezus, kur të arrish në Mbretërinë tënde!«

Jezusi i tha:

»Për të vërtetë po të them: Sot do të jesh me mua në parriz!«

Në këmbë, përngjat kryqit të Jezusit, qëndronin nëna e tij, pastaj motra e nënës

së tij, Maria e Kleofit dhe Maria Magdalenë. Jezusi, kur pa nënën e vet dhe, përngjat saj, nxënësin që e donte, i tha nënës:

»Fisnike, qe yt bir!«

Pastaj i tha nxënësit:

»Qe nëna jote!«

Qysh atëherë nxënsi e mori me vete.

Jezusi jep shpirt

Ishte rreth orës gjashtë kur u bë terr mbi mbarë tokën — deri në orën nëntë:

u zu dielli. Rreth orës nëntë Jezusi lëshoi një gjëmë të madhe e tha:

»Eloi, Eloi! Lama sabaktani?!« që përkthehet: »Hyu im! Hyu im! Përse hoqe dorë prej meje?!«

Disa prej atyre që ishin pranë, kur e dëgjuan, thanë: »Ja, ky po thërret Elinë!«

Pastaj, Jezusi, duke ditur se u krye gjithçka — që të shkojë në vend fjala e Shkrimit shenjt, tha:

»Kam et!«

E aty ishte një enë plot me uthull.

Njëri prej tyre u lëshua vrap, e zhyti një shpuzë në uthull, e vuri në kallam e ia shtriu ta pinte duke thënë:

»Pale, të shohim a po vjen Elia ta shpëtojë!«

Jezusi, posa e kërkoi uthullën, tha: »Gjithçka u krye!«

Jezusi lëshoi rishtas një brimë të madhe e tha:

»O Atë, në duar tua po e porosis shpirtin tim!«

Si i tha këto fjalë, uli kryet e dha shpirt.

Dhe, ja, veli i Tempullit u shqye në dy pjesë, për mjedisit, prej majes e deri në fund, toka u lëkund e shkëmbënjtë u plasën, varret u hapën e u ngjallën shumë trupa të drejtish që kishin pasë vdekur. E dolën nga varret.

Centurioni, që rrinte kundruall Jezusit, kur pa se çka ndodhi dhe se si dha shpirt, zu të lavdurojë Hyun e të thotë:

»Me të vërtetë ky njeri paska qenë i drejtë!«

Kështu edhe ata që bashkë me të po e ruanin Jezusin po edhe mbarë gjindja që ishin bashkuar për të parë ngjarjen, kur panë termetin dhe mbarë çka ndodhi, thanë:


»Për të vërtetë ky paska qenë Biri i Hyut!«

E u kthenin duke u rrahur në parzëm.

Të gjithë të njohurit e tij rrinin m'anesh. Aty ndodhnin edhe shumë gra që vërenin prej së largu. Ato e kishin prëcjellë Jezusin prej Galilesë dhe i kishin shërbyer. E ishin edhe shumë të tjera që ishin ngjitur bashkë me të në Jerusalem.

Jezusin e varrosin

Atëherë hebrenjtë, mbasi ishte dita e Pregatitjes dhe, për të mos mbetur trupat në kryq të shtunën — e ishte ditë e madhe ajo e shtunë — i bënë lutje Pilatit t'u theheshin eshtrat të kryqëzuarve e të uleshin. Erdhën, pra, ushtarët e ia thyen kërcinjtë të parit dhe të dytit që ishin të kryqëzuar me të. Kur erdhën te Jezusi e, si panë se kishte vdekur, nuk ia thyen kërcinjtë, por njëri prej ushtarëve ia shporoi



me heshtë krahërorin dhe menjëherë rrodhi gjak e ujë.

Kur u bë natë, erdhi Jozefi prej Arimateësë, qytet i Judesë. Ishte nxënës i fshehtë i Jezusit — për shkak të drojes së çifutëve — burrë i mirë dhe i drejtë e nuk e miratoi vendimin as mënyrën e tyre e mori guxim dhe hyri te Pilati e ia lypsi trupin e Jezusit. Pilati, i çuditur se kishte vdekur, thirri centurionin dhe e pyeti a kishte shumë kohë që kish vdekur. Si mori vesh prej centurionit, ia dhuroi Jozefit trupin e Jezusit.

Jozefi, pra, bleu pëlhurën, shkoi e e uli trupin e Jezusit, e mbështuall në pëlhurë të pastër, sikurse është doke të bëhet ndër hebrenj kur varrosin ndokënd.

E në atë vend ku qe kryqëzuar Jezusi, ishte një kopsht e në kopsht ishte një varr, që Jozefi e kishte çelur në shkëmb, në të cilin ende nuk ishte varrosur kush. Këtu, pra, për arsye të Pregatitjes së çifutëve, dhe pse varri ishte ngjat, e venduan Jezusin.

Mbas Jozefit në përcjellje erdhën edhe gratë që kishin ardhur me Jezusin prej Galilesë e panë si e ku e varrosën trupin e Jezusit. Kur u kthyen, pregaditën erëra të mira e vajëra të erandshëm, e të shtunën mbajtën pushimin sipas rregullores.

Të nesërmen — që ishte dita pas Pregatitjes (*e shtunë*), kryepfistërinjtë dhe farisenjtë u bashkuan te Pilati dhe i thanë:


»Zotëri, na ra ndër mend se ai gënjeshitari për të gjallë të vet e ka thënë këtë fjalë: 'Pas tri ditësh do të ngjallëm. Prandaj, urdhëro të ruhet varri deri të tretën ditë, që mos të shkojnë nxënësit e tij e mos ta vjedhin e t'i thonë popullit: 'Është ngjallur prej së vdekurish,' e mos të dalë gënjeshtra e fundit më e zezë se e para.«

Pilati u përgjegji:

»Rojën e keni, shkoni e ruane si të dini!«

Ata shkuan dhe e siguruan varrin: vulosën gurin dhe e vuan rojën.

Të ngjallurit e Jezusit



Pas të shtunës, në të zbardhur të dritës, të së parës ditë të javës, Maria Magdale-në dhe ajo Maria tjetër shkuan për ta parë varrin.

Dhe, ja, ra një termet i madh, sepse engjëlli i Zotit zbriti nga qielli, u afrua e rrotulloi gurin dhe u ul mbi të. Fytyra e tij ishte si vetëtimja, e petku i tij i bardhë porsi bora. Rojëtarët, prej frikës së tij, u tmerruan dhe u bënë porsi të vdekur. Gratë shikuan, kur qe, guri ishte i rrokullisur! Ishte me të vërtetë i madh!

Atëherë engjëlli u tha grave:

»E di, ju kërkoni Jezusin Nazarenas, të

kryqëzuarin. Pse e kërkoni të gjallin ndër të vdekur? Nuk është këtu, është ngjallur sikurse ka thënë. Ejani e shihni vendin ku qe vënë. T'u bjerë në mend çka u ka thënë kur ishte në Galile, kur u thoshte: 'Duhet që Biri i njeriut të lëshohet në duar të mëkatnorëve, të kryqëzohet dhe të tretën ditë të ngjallet.' Nisuni me shpejt dhe lajmëroni nxënësit e tij dhe Pjetrin se është ngjallur prej të vdekurish dhe se po shkon para jush në Galile; atje do ta shihni sikurse u ka thënë. Ja, u tregova!«

Ato menjëherë dolën nga varri, me frikë e njëheri me gëzim të madh dhe shkuan

me nxitim t'i njoftojnë nxënësit e tij.

Dhe, ja, papritmas, u doli Jezusi përpara e u tha: »U falem!«

Ato u afruan, i ranë ndër këmbë dhe e adhuruan.

Atëherë u tha Jezusi:

»Mos kini frikë! Shkoni e lajmëroni vëllezërit e mi të shkojnë në Galile. Atje do të më shohin.«

Jezusi u lajmërohet nxënësve

Po atë ditë, pas të gjitha këtyre që ndodhën, dy nxënës po shkonin në një

fshat, larg Jerusalemit gjashtëdhjetë stadje, që quhet Emaus. Këta bisedonin me shoqishoqin për të gjitha këto që kishin ndodhur. E ndodhi që, ndërsa ata po bisedonin kështu dhe po diskutonin, vetë Jezusi u afrua në një trajtë tjetër e po ecte me ta. E sytë e tyre ishin të penguar ta njihnin.

Ai i pyeti: »Ç' janë këto fjalë që po i flisni udhës njëri me tjetrin?«

Ata zunë vend të trishtueshëm dhe i përgjegji njëri prej tyre, ai që quhet Kleofë:

»Athua je ti i vetmi i huaj në Jerusalem, që s'e di se çka ka ndodhur në të po në këto ditë?«

Ai i pyeti: »Po çka?«

I përgjegjën: »Çka i ndodhi Jezusit Nazarenas, që ishte profet — i madhërueshëm me fjalë e me vepra në sy të Hyut e të popullit mbarë; se si kërret e priftërinjve dhe këshilltarët tanë e dorëzuan të dënohet për vdekje dhe e kryqëzuan. E ne shpresonim se ai do ta çlironte Izraelin. Por edhe përmbi të gjitha këto — sot është e treta ditë që kanë ndodhur këto ngjarje. Madje shtoi edhe se disa gra prej nesh na i morën mend më zi: ato qenë në agim ke varri e, duke mos e gjetur trupin e tij, erdhën e na thanë se u janë dukur engjëj, të cilët u paskan thënë se ai është gjall. Po edhe disa prej nesh shkuan te varri dhe gjetën po ashtu si thanë gratë, por atë nuk e panë.«

Jezusi u tha: »O njerëz të pa kuptim e të ngadalshëm për të besuar gjithçka kanë paralajmëruar profetët! Po a nuk është dashur që Mesia t'i pësonte të gjitha këto e kështu të hyjë në lavdinë e vet?«

E duke filluar prej Moisiut e prej të gjithë profetëve u shtjelloi gjithçka flitet për të në mbarë Shkrimin shenjt. Kur iu afruan fshatit ku ishin nisur, ai bëri kinse po e vazhdonte udhën. Por ata iu vunë:

»Rri me ne se u bë natë e dita ka shkuar në të sosur!«

Hyri për të bujtur me ta.

Jezusi then bukën

Kur u ul me ta në tryezë, mori bukën, u falënderua (Hyut), e theu dhe ua dha. Atyre u çelën sytë dhe e njohën, por ai u zhduk prej syve të tyre.

Atëherë i thanë njëri-tjetrit: »Po a nuk ndezet zemra jonë në ne ndërsa bisedonte udhës e na spjegonte Shkrimin shenjt?«

Menjëherë u ngritën e kthyen në Jerusalemin, ku i gjetën të bashkuar të Njëmbëdhjetit dhe ata që ishin me ta.

Këta edhe u thanë:

»Më të vërtetë është ngjallur Zotëria dhe iu dëftua Simonit!«

Atëherë edhe këta u treguan çka u kish ndodhur udhës dhe si e njohën kur u ndau bukën.

As këtyre nuk u zunë besë.

Jezusi ngrën peshk të pjekur

Ndërsa këta po bisedonin për këto punë, Jezusi zu vend në midis të tyre dhe tha:

»Paqa me ju!«

Të tmerruar e të frikësuar mendonin se po shihnin ndonjë shpirt.

Jezusi u tha:

»Pse po tuteni? Pse dyshoni në zemrat tuaja? Shikoni duart e mia e këmbët e mia: unë jam vetë! Më prekni e më kqyrni se shpirti s'ka mish e eshtra, si po shihni se unë kam!«

Pastaj i qortoi për pabesimin e tyre dhe për ngurtësinë e zemrës, pse s'u kishin besuar atyre që e kishin parë të ngjallur. E pasi ata prej gëzimit e prej habisë ende nuk mund të besonin, Jezusi u tha:

»A keni këtu ndonjë gjë për të ngrënë?«

Ata i prunë një kurm peshku të pjekur. Ai e mori dhe e ngrëni para tyre.

Pastaj Jezusi u tha rishtas:

»Paqa me ju! Sikurse Ati më dërgoi mua, edhe unë po ju dërgoi ju.«

Si foli kështu, hukati mbi ta dhe tha:

»Merrne Shpirtin Shenjt! Atyre që t'ua falni mëkatet, do t'u falen; atyre që mos t'ua falni, nuk do t'u falen.«

Toma nuk beson

E Toma, njëri prej të Dymbëdhjetëve — ai që quhet Binak — nuk ndodhi me ta kur erdhi Jezusi. I thoshnin, pra, nxënësit e tjerë: »E kemi parë Zotërinë.«

Toma u përgjegji:

»Nëse nuk e shoh në duart e tija shenjë e gozhdave e nuk e fus gishtin tim në vend të gozhdave; nëse nuk e shtie dorën time në krahërorin e tij, nuk do të besoj.«

Mbas tetë ditëve, nxënësit e tij ishin rishtas brenda e me ta ishte edhe Toma. Ndërsa dyert ishin të mbyllura, erdhi Jezusi, zu vend në midis të tyre dhe u tha:

»Paqa me ju!«


Pastaj i tha Tomës: »Bjere gishtin tënd këtu dhe, ja, kqyri duart e mia! Bjere dorën tënde dhe shtjere në krahëror tim e mos ji i pabesim, por njeri që beson!«

Toma i përgjegji:

»Zoti im dhe Hyu im!«

Jezusi i tha: »Besove pse po më sheh! Të lumët ata që nuk panë e besojnë!«





Në liqenin e Tiberiadit

Pastaj Jezusi u dëftua rishtas nxënësve në detin e Tiberiadit. U dëftua kështu: Ishin bashkë Simon Pjetri, Toma që quhet Binak, Natanaeli, nga Kana e Galileë, të bijtë e Zebedeut edhe dy të tjerë prej nxënësve të tij.

U tha Simon Pjetri: »Po shkoj të gjuaj peshk.«

I thanë: »Po vijmë edhe ne me ty.«

Dolën, pra, hynë në barkë, por atë natë nuk zunë gjë.

Kur zbardhi drita, qe, Jezusi në breg. Nxënësit nuk dinin se ishte Jezusi. Jezusi u tha:

»Djelmosha, a nuk keni ndopak peshk për të ngrënë?«

I përgjegjën: »Jo!«

Ai u tha: »Qitne rrjetën në anë të djathtë të barkës e do të gjeni.«

Ata e qitën dhe nuk mundin më ta nxirrnin prej shumicës së peshkut. Atëherë ai nxënësi, të cilin Jezusi e donte veçanërisht, i tha Pjetrit: »Zotëria është!«

dhej. Dhe, megjithëse ishin aq shumë, prap nuk u shqye rrjeta.

Jezusi u tha: »Ejani e hani!«

Askush prej nxënësve nuk pati guxim ta pyesë: »Kush je ti?« sepse e dinin mirë se ishte Zotëria. Jezusi u afrua, mori bukën dhe ua dha. Po ashtu bëri edhe me peshk.

Kjo qe hera e tretë që Jezusi u dëftua nxënësve të vet pasi u ngjall ë vdekurish.

Jezusi ngjitet në qiell

Jezusi, pas mundimit të vet, me shumë prova ua vërtetoi apostujve se është gjallë: u shfaq për dyzetë ditë dhe u foli mbi Mbretërinë e Hyut.

Një herë, ndërsa ishte në tryezë me ta, u urdhëroi të mos ta lëshonin Jerusalemin, por ta prisnin aty premtimin e Atit — u tha — për të cilin dëgjuat prej meje: Gjoni ka pagëzuar me ujë, ndërsa ju do të pagëzoheni, mbas pak ditësh, me Shpirt Shenjt.«

Tashti, ata që ndodhën me të, e pyetën: »Zotëri, athua në këtë kohë do ta përtrish Mbretërinë në Izrael?«

Ai u përgjegj: »Nuk është puna e juaj ta njihni kohën dhe momentin, që Ati i ka lënë në pushtetin e vet. Por do ta merrni fuqinë e Shpirtit Shenjt, i cili do të zbresë mbi ju dhe ju do të bëheni dëshmitarët e mi në Jerusalem, në mbarë Judenë, Samarinë dhe deri në skajin e tokës.«

Kur i tha këto fjalë, qe ngritur ndër sy të tyre e një re ua zu syvet të tyre. Dhe, ndërsa ata ngulas po shikonin se si ngjitet në qiell, kur qe, dy njerëz të veshur me petka të bardha, zunë vend para tyre e u thanë:

»Burra galileas, pse rrini kështu duke shikuar në qiell? Ky Jezus, që prej jush u muar në qiell, po kështu do të vijë, sikurse e patë se shkoi në qiell!«

Ata e adhuruan me fytyrë për dhe e me gëzim të madh u kthyen në Jerusalem e vazdhimisht qëndronin në Tempull duke i dhënë lavdi Hyut.

Simon Pjetri, kur dëgjoi se është Zotëria, u mbështuall me petkun e sipërm — sepse ishte i zhveshur — dhe kërcëu në det. Nxënësit e tjerë erdhën me barkë duke hequr rrjetën me peshk, sepse nuk ishin larg bregut — kund dyqind kutë.

Si dolën në breg, panë zjarrin me prush e mbi të peshk e bukë.

Jezusi u tha: »Bini peshk që zutë tani!«

Atëherë Simon Pjetri hypi në barkë, e nxori në tokë rrjetën plot me peshk: njëqind e pesëdhjetë e tre peshq të më-

Kisha
e hershme

Ardhja e Shpirtit Shenjt

Kur erdhi dita e Rrëshajëve, të gjithë ishin bashkë në të njëjtin vend. Dhe, ja, papritmas krisi një ushtimë prej qiellit, si shungullimë e një ere së fortë dhe e mbushi shtëpinë, ku ata po gjendeshin. Dhe atyre e dukën gjuhë si të ishin zjarrri, që u ndanë e zunë vend nga një mbi secilin prej sish. Të gjithë u mbushën me Shpirtin Shenjt e filluan të flasin në gjuhë të ndryshme, ashtu si Shpirti Shenjt u jepte të shpreheshin.

E në Jerusalem banonin aso here hebrenj, njerëz të përshpirshëm, prej të gjitha kombeve të botës. Kur u dëgjua ajo ushtimë, rrani një shumicë e madhe dhe mbetën të habitur, sepse secili i dëgjonte duke folur në gjuhën e tij. Të gjithë çuditeshin e mrekulloheshin e thoshnin:

»Këta njerëz që po flasin, athua nuk janë të gjithë galileas? E si atëherë, secili prej nesh i dëgjon duke folur në gjuhën e vet amtare? Partë e medë, elamitë e banorë të Mezopotamisë, të Judesë e të Kapadokisë, të Pontit e të Azisë, të Frigjisë. e të Pamfilisë, të Egjiptit e të krahinave të Libisë rreth Cirenës, njerëz të ardhur prej Romës, hebrenj e prozelitë, kretas e arabë — të gjithë po i dëgjojmë duke shpallur veprat e madhërueshme të Hyut në gjuhët tana amtare.

Të gjithë kishin mbetur të habitur e, të marrë mendsh, pyesnin njëri-tjetrin: »Çka do të jetë kjo punë se?«



Do të tjerë, duke shpotitur, thoshnin: »Janë dehur me verë të ëmbël!«

Atëherë Pjetri, bashkë me të Njëmbdhjetit, u ngrit, e lartësoi zërin dhe tha:

»Burra të Judesë dhe ju të gjithë që banoni në Jerusalem, dinie këtë dhe dëgjoni fjalët e mia! Nuk janë këta të dehur, sikurse ju po kujtoni — ju po shini se është ora e nëntë e mëngjesit — por, po shkon në vend fjala që parafoli Joeli profet:

'Në ditën e fundit — thotë Zoti, do ta ndikoj Shpirtin tim mbi çdo njeri

djelmoshat tuaj do të shohin vegime e pleqtë tuaj do të shohin ëndrra.

Madje edhe mbi shërbëtorë e shërbëtore

të mia

do ta ndikoj Shpirtin tim në atë ditë e do të profetizojnë.'

Burra të Izraelit, dëgjonie këtë fjalë: Jezusin Nazarenas, njeri të cilin Hyu e përforcoi — para jush me vepra të madhërueshme, me mrekulli dhe me shenja, të cilat sikurse e dini — nëpër të i bëri midis jush. Këtë, të tradhtuar simbas

vullnetit të caktuar të parapamjes së Hyut — ju e kreyqëzuat me duar të të pafeve. Porse Hyu e ngjalli duke e shpëtuar nga tmerrri i vdekjes.«

Ata që e pranuan fjalën e tij, u pagëzuan, e kështu, atë ditë, u kthyen rreth trimijë vetë.

Ishin vazhdimisht të kujdesshëm ta përvetsonin mësimin e apostujve, nuk mungonin në mbledhjet vëllazërore, në ndamjen e bukës e në lutje.

Një frikë e madhe pushtonte çdo njeri: apostujt bënin shumë mrekulli dhe shenja

të bindshme. Të gjithë ata që besonin, qëndronin së bashku dhe kishin gjithçka të përbashkët. Shitnin prona e pasuri që kishin dhe i ndanin ndër të gjithë sipas nevojës së secilit. Për ditë shkonin së bashku e rregullisht në Tempull, në shtëpi ndanin bukën dhe, me hare e me thjeshtësi, ushqeheshin të gjithë së bashku. Ata e lavduronin Hyun e populli mbarë i kishte fort për hir. Vetë Zoti çdo ditë i shtonte bashkisë të shpëtuar.

Pjetri shëron të shqiptin

Pjetri e Gjoni po ngjiteshin në Tempull për lutjen e orës tre pas dreke. Tashti, atëherë po e sillnin një njeri të çal që prej lindjes. E sillnin përditë te dera e Tempullit, ke ajo që quhet »E bukura«, për të lypur lëmoshë prej atyre që hynin në Tempull. Ky, kur i pa Pjetrin e Gjonin duke hyrë në Tempull, u shtriu dorën t'i jepnin lëmoshë. Pjetri atëherë, bashkë me Gjonin, ia nguli sytë e i tha: »Kqyrna!«

Ai po i vërente me kujdes duke shpre-suar se do të merrte ndonjë send.

Atëherë Pjetri i tha:


»Unë nuk kam as serm as ar — por çka kam, po të jap: në emër të Jezusit Nazarenas, ec!«

E kapi për dore së djathtë dhe e ngriti në këmbë: aty për aty u forcuan këmbët e të gjitha nyejet e këmbëve të tija, dhe kërcëu, u ndreq, filloi të ecë e hyri në Tempull. Ecte, kërcente dhe i jepte lavdi Hyut!

Mbarë populli e pa duke ecur dhe i dha lavdi Hyut. Njerëzit e njohën se ishte ai që, ndenjur para derës së »Bukur« të Tempullit, lypte lëmoshë dhe mbetën shtang të mrekulluar prej habitës për çka i ndodhi atij.

E mbasi ky nuk u ndahej Pjetrit e Gjonit, mbarë populli, i mrekulluar rrani ke ata në tremin që quhet i Salamonit.

Pjetri, kur i pa, iu drejtua popullit: »Burra të Izraelit, pse po çuditëni për këtë gjë? Pse po na shikoni, thua se ne me fuqinë tonë e me përshtirtninë tonë kemi bërë që ky të ecë? Hyu i Abrahamit,



Hyu i Izakut e Hyu i Jakobit, Hyu i etërve tanë e lavduroi shërbëtorin e vet Jezusin, të cilin ju e dorëzuat edhe i ratë mohit para Pilatit, kur ai kishte vendosur

dëshmojnë. Në fuqi të besimit në Emrin e tij, këtij njeriu që ju e njihni, ky Emër i dha forcë, feja në të ia ktheu shëndetin në sy të gjithë juve këtij njeriu.«

Apostujt në burg

Ndërsa ata ende po i flisnin popullit, priftërinjtë, komandanti i policisë së Tempullit dhe saducenjtë u afruan të hidhëruar pse e mësonin popullin dhe pse u predikonin në Emër të Jezusit ngjalljen prej së vdekurish, vunë dorë mbi ta dhe i qitën në burg deri më nesër, sepse ishte bërë natë.

Shumë asish që dëgjuan fjalën e tyre, besuan dhe numri u shtua rreth pesë mijë.

Të nesërmen u bashkuan në kuvend në Jerusalem krerët, priftërinjtë dhe skribët e me ta edhe kryepriftërinjtë Ana e Kajfa, Gjoni, Aleksandri dhe të gjithë anëtarët e familjeve të kryepriftërinjve e, pasi i prunë para tyre, i morën në pyetje:

»Me ç'pushtet dhe në emër të kujt e bëtë atë gjë?«

Atëherë Pjetri, plot me Shpirt Shenjt, u tha:

»Në emër të Jezusit Nazarenas, të cilin ju e kryqëzuat, por të cilin Hyu e ngjalli prej të vdekurish: në saje të tij ky njeri qëndron para jush shëndosh.«

Kur vunë re se Pjetri e Gjoni s'po trembeshin e, mbasi e dinin se janë të pashkolluar e të pa shkrim — kishin mbetur të habitur. I njihnin se kishin qenë me Jezusin, por shihnin edhe se me ta ishte edhe njeriu që u shërua e nuk dinin ç'të thoshnin. Prandaj u urdhëruan të dalin nga Këshilli dhe filluan të diskutojnë ndër vete:

»Çka të bëjmë me këta njerëz? Kanë bërë mrekulli të qartë, të cilën e pranojnë mbarë jerusalemasit e s' është punë që mund ta mohojmë; por që më tepër mos të shpërhallet në popull, po u ndalojmë mos t'i flasin më kujt për atë emër.«

I thirrën, pra, dhe u urdhëruan që asesi mos të flasin as mos të mësojnë më në Emër të Jezusit.

ta lirojë. Ju mohuat Shenjtin dhe të Drejtin e kërkuat t'u lirohej gjaksori e vratë Dhënësin e jetës. Por atë Hyu e ngjalli prej të vdekurish, të cilën ngjallje ne e



Por Pjetri e Gjoni u përgjegjën: »Gjykoni ju vetë a është e drejtë para Hyut t'u dëgjojmë më fort juve se Hyut? Ne me të vërtetë nuk mundemi të mos flasim çka kemi parë e dëgjuar.«

E ata, pasi rishtas u bërtitën, i lanë të shkojnë; sepse nuk gjetën arsye pse t' i ndëshkojnë për shkak të popullit, pse të gjithë i jepnin lavdi Hyut për shkak të mrekullisë që u bë.

E nëpër duar të apostujve bëheshin shumë shenja e mrekulli në popull, kështu që qitnin në tregje të sëmurit, i vënin në vigj e shtroja që, duke kaluar asaj Pjetri, së

paku hija e tij t'i binte ndonjërit prej tyre. E rrante shumicë e madhe edhe nga qytetet për rreth Jerusalemit: sillnin të sëmurë dhe asish që i kishin pushtuar shpirtat e ndytë dhe të gjithë u shëronin. Askush prej të tjerëve nuk kishte guxim të bashkohej me ta, porse megjithatë populli i nderonte. E gjithnjë shtoej numri i burrave e i grave që besonin në Zotin.

Atëherë u ngrit kryepriifti dhe mbarë ata të partisë së tij — sekta e saducenjve. Plot sëmirë vunë dorë mbi apostuj e i qitën në burg të përgjithshëm.

Çlirimi i apostujve

E natën engjëlli i Zotit hapi dyert e burgut, i nxori jashtë dhe u tha: »Shkoni në Tempull dhe vazhdoni t'ia kumtoni popullit të gjitha fjalët e kësaj Jete.«

Ata dëgjuan e në agim hynë në Tempull dhe mësonin.

Ndërkaq arriti kryepriifti dhe ndjekësit e tij, thirrën Këshillin e lartë dhe mbarë Parësinë e të bijve të Izraelit dhe dërguan në burg për t'i sjellë apostujt. Rojëtarët, si shkuan në vend, nuk i gjetën në burg, u kthyen dhe u lajmëruan:

»Burgun e gjetëm të mbyllur me kujdes dhe rojëtarët në rojë para dere, por kur e çelëm, nuk gjetëm askë brenda.«

Kur e dëgjuan lajmin, komandanti i policisë së Tempullit dhe kryepriiftërinjtë, të habitur, pyesnin: çka do të thotë kjo punë?

Atëherë ia behi dikush e tha:

»Njerëzit që ju qitën në burg, ja, janë në Tempull e po mësojnë popullin.«

Atëherë shkoi komandanti me policinë e Tempullit dhe i pruri — jo me dhunë, sepse dronin mos t'i vriste populli me gurë.

Shtjefni, martiri i parë

Apostujt i zgjodhën shtatë vetë për t'i pasur ndihmës në shërbim të besimtarëve. Ndër ta u nda në shenjë Shtjefni. Ai plot me hir e fuqi bënte mrekulli e shenja të mëdha në popull. Ndërkaq u çuan kundër disa prej ashtu të quajturës sinagogës së libertinëve, të cirenianëve, të aleksandrinëve, të atyre prej Cilicisë e të Azisë e filluan të diskutonin me Shtjefnin, por nuk mund i qëndronin për ballë dijes dhe Shpirtit në fuqi të cilit fliste.

Atëherë prunë disa që thanë: »E kemi dëgjuar duke folur fjalë fyese kundër Moisiut e kundër Hyut.«

Ngucën popullin, pleqtë e skribët, atëherë iu afruan, e kapën dhe e çuan në Këshill. Aty qitën dëshmitarë në rrenë, të cilët thanë: »Ky njeri vazhdimisht flet kundër Vëndit të shenjtë dhe kundër Ligjit. Me të vërtetë e dëgjuam duke folur: Jezusi Nazarenas do ta rrenojë këtë vend

dhe do t'i shndërrojë traditat që na i ka lënë Moisiu.«

Atëherë të gjithë ata që ishin në kuvend i drejtuan sytë në të e panë se fytyra e tij ishte — si fytyrë engjëlli.

Shtjefni mbrohet

E ai, plot me Shpirt Shenjt, i çoi sytë kah qielli, pa Lavdinë e Hyut dhe Jezusin duke ndenjur në të djathtë e Hyut e tha:

»Qe, po i shoh qiejtë e hapura dhe të Birin e njeriut duke ndenjur në të djathtë e Hyut!«

Ata atëherë lëshuan një brimë të madhe, i mbyllën veshët dhe u lëshuan të gjithë së bashku në të. E qitën përjashta qytetit dhe zunë ta vrasin me gurë.

Dëshmitarët i ulën petkat ke këmbët e një djaloshi, që quhej Saul.

Dhe e vranë me gurë Shtjefnin ndërsa lutej e thoshte:

»O Zot, Jezus, merre shpirtin tim!«
Atëherë ra në gjunj e bërtiti me zë të lartë:

»O Zot, mos ua merr këtë për mëkat!«
Si i tha këto fjalë, dha shpirt.

Kthimi i Saulit

Edhe Sauli e dha pëlqimin e vet të vritet Shtjefni.

Sauli gjithnjë shfrente me kërcenime vrasjeje kundër nxënësve të Zotit, kështu erdhi ke kryepriifti, kërkoi prej tij letrat për sinagogat e Damaskut, që, nëse do të gjejë ndokë të kësaj Feje, burra e gra, t'i bjerë të lidhur në Jerusalem.

Kur, duke udhëtuar, iu afrua Damaskut, papritmas e shndriti një dritë prej qiellit. U rrxua për dhe dhe dëgjoji një zë që i tha:

»Saul, Saul, përse po më salvon?«

Ai pyeti: »E kush je ti, o Zot?«

E ai: »Unë jam Jezusi, të cilin ti e salvon! Por çohu e hyr në qytet e do të



tregohet çka të duhet të bësh.»

Bashkudhëtarët e tij zunë vend pa bërë ver me gojë të habitur, sepse zërin njëmend e dëgjuan, por nuk panë askë.

Sauli u ngrit nga toka, por, edhepse i kishte hapur sytë, nuk shihte asgjë. E shtinë në qytet duke e marrë për dore.

Në Damask ishte një njeri që quhej Anani. Këtij Zoti i tha në vegim: »O Anani!«

Ai përgjegji: »Urdhëro, o Zot!«

Zoti vazhdoi: »Çohu dhe shko në rrugën që quhet e Drejtë e në shtëpinë e Judës lype njeriun prej Tarsit, që quhet Saul. Ja se ai lutet, dhe në vegim e ka parë një

njeri që quhet Anani duke hyrë ke ai e duke i vënë duart për t'ia rikthyer të pamit e syvet.«

Anania i përgjegji: »O Zot, prej shumëkujt kam dëgjuar për atë njeri, sa shumë të këqia u ka bërë shenjterve tu në Jerusalem. Ai ka edhe fuqizimin prej kryepriestërinjve të lidhë në hekura të gjithë ata që e thërrasin në ndihmë Emrin tënd.«

Zoti i përgjegji: »Shko se ai është veglaime, të cilin unë e kam zgjedhur për ta çuar emrin tim para paganëve, para mbretërve dhe para bijve të Izraelit. E do t'i tregoj se sa shumë do t'i duhet të pësojë për shkak të Emrit tim!«

Sauli bëhet i krishterë

Anania shkoi, hyri në shtëpi e, duke ia vënë duart, i tha:

»Vëlla, Saul! Zoti, Jezusi, që t'u dëftua në udhë kur ishe duke ardhur, më ka dërguar që ta rifitosh dritën e syve e të mbushesh me Shpirtin Shenjt.«

Dhe aty për aty i ra diçka prej syve si pare peshku dhe menjëherë iu kthye të pamit e syve, u ngrit, qe pagëzuar, ngrëni dhe u përtri në fuqi.

Ndenj disa ditë në Damask bashkë me

nxënës dhe menjëherë filloi të predikojë në sinagoga se Jezusi është Biri i Hyut. Të gjithë ata që e dëgjonin, mrekulloheshin e thoshnin:

»Po a nuk është ky ai që në Jerusalem ua tretëte farën atyre që e thërrisnin në ndihmë këtë Emër? Po edhe këtu erdhi për t'i çuar të lidhur në hekura para kryepriestërinjve?«

Sauli gjithnjë e më tepër merrte guxim dhe i hutonte hebrenjtë që banonin në Damask duke ua vërtetuar se Jezusi është Mesia.

Pasi kaloi mjaft kohë, hebrenjtë prunë vendimin ta vrasin.



Sauli e hetoi synimin e tyre. Ditë e natë i ruanin dyert e qytetit, por nxënësit e tij e morën natën dhe, në një shportë, e ulën poshtë për murit.

Sauli kur erdhi në Jerusalem, mundohej të bashkohej me nxënës.

Mësimi i Pjetrit

Në Cezare ishte një njeri për emër Kornel, kapiten i togës që quhet »Italike«, njeri i përsipirtshëm dhe që besonte në një Hy të vetëm ai e mbarë familja e tij. Popullit çifut i ndante shumë lëmoshë e i lutej Hyut vazhdimisht.

Në një vegim, diku rreth orës tre pas dreke pa qartazi engjëllnin e Hyut se hyri tek ai dhe e thirri: »O Kornel!«

Korneli e shikoi dhe, i frikësuar, i tha: »Urdhëro, zotëri!«

Ai i përgjegji: »Lutjet dhe lëmoshat tua

kanë arritur para Hyut dhe ai të ka kujtuar. Ti tani dërgoj disa njerëz në Jopë dhe grishe Simonin që quhet Pjetër. Ai gjendet te një farë Simoni, lëkurtar që e ka shtëpinë përngjat detit.«

Posa shkoi engjëlli që foli me të, i grishi dy shërbëtorë e një ushtar të përsipirtshëm, prej atyre që gjithmonë ishin me të, u tregoi gjithçka dhe i nisi në Jopë.

Të nesërmen, ndërkohë që ata ishin në udhëtim dhe po i afroreshin qytetit, ishte diku rreth mesditës, Pjetri doli në tarracë për t'u lutur. U untua dhe dëshiroi të ngrënë. Ndërsa ata po i pregatisnin, Pjetri kaloi në ekstazë. Shihte ai qiellin e hapur dhe një send të pacaktueshëm, pors i një pëlhurë të madhe, të lidhur në katër këndet, që po zbriste nga qielli në tokë. Në të ishin katërkëmësh të ndryshëm, rrëshqanës tokësorë dhe shpendë të qiellit. Një zë i tha:

»Pjetër, çohu, pre dhe ha!«

»Asesi, o Zot! Unë askurrë nuk kërkova me gojë kafshë të ndytë e të papastër!« Ai zë i tha rishtas të dytën herë:

»Çka Hyu ka pastruar, ti mos e quaj të papastër!« Kjo u përsrit tri herë e pastaj ai send u ngjit në qiell.

Ndërkohë që Pjetri po e vriste me vet-vete mendjen se ç' do të thotë vegimi që pati, ja, njerëzit e dërguar prej Kornelit, ia behën te dera.

Pjetri dhe centurioni

Të nesërmen u çua e shkoi me ta. Disa vëllezër prej Jopës e përcollën Pjetrin. Të dytën ditë hynë në Cezare. Korneli i priste dhe kishte grishur edhe farefisën e miqtë e ngushtë. Kur Pjetri po hynte Korneli i doli para e, duke rënë ndër këmbët e tija, e adhuroi.

Pjetri e ngriti dhe i tha: »Ngritu se edhe unë jam vetëm njeri!«

E duke biseduar me të, hyri brenda, gjeti shumë të bashkuar, të cilëve u tha:

»Ju e dini se një hebre e ka të ndaluar të bëjë shoqëri me të huaj ose të hyjë në shtëpi të tij, porse vetë Hyu më mësoi se s' është e lejueshme të quhet i ndytë ose i papastër asnjë njeri. Prandaj, kur më grishët, erdha pa u vonua. Të shohim, pra, për çka më keni thirrë.«

Pasi Korneli i tregoi vegimin që pati, atëherë Pjetri e mori fjalën:

»Tani me të vërtetë po e marr vesh se Hyu nuk i mba kujt krah, porse — në çdo kombësi i pëlqen ai që e nderon atë dhe që kryen çka ai urdhëron.«

Ndërsa Pjetri po thoshte këto fjalë, Shpirti Shenjt zbriti mbi të gjithë ata që po e dëgjonin predkun. Besimtarët prej rrethprerjes që kishin përcjellë Pjetrin, kur panë se edhe mbi paganë u ndikua dhurata e Shpirtit Shenjt — u habitën. Sepse i dëgjuan duke folur gjuhë të ndryshme e duke madhëruar Hyun.



Atëherë Pjetri tha:
 »Vallë, kush mund ta ndalojë ujin, që këta mos të pagëzohen, të cilët e morën Shpirtin Shenjt sikurse ne?«
 Atëherë dha urdhër të pagëzohen në emër të Jezu Krishtit. Ata i bënë lutje të rrijë disa ditë ndër ta.

Pjetri në burg

Ndër ato ditë mbreti Herod filloi të salvojë disa prej Kishës. Me shpatë e preu Jakobin, të vëllanë e Gjonit. Kur pa se kjo gjë po u pëlqente hebrenjve, e burgosi edhe Pjetrin. Ishin ditët e Bukëve të pabruara.

E zu, pra, e qiti në burg dhe ua dha ta ruajnë katër skuadrave, secila nga katër ushtarë, me qëllim që mbas Pashkësh ta qesë para popullit. Ndërsa, pra, Pjetri po ruhej në burg, Kisha vazhdimisht i lutej Hyut për të.

Një natë para se Herodi mendonte ta qesë para popullit, Pjetri flente në midis dy ushtarëve i lidhur në dy parë pranga e para derës rojëtarët e ruanin burgun. Dhe, ja, engjëlli i Zotit u duk dhe një dritë e shndriti dhomën.

Engjëlli i ra Pjetrit në ijë, e zgjoi dhe i tha:

»Çohu shpejt!«

Prej duarve i ranë hekurat.

Atëherë engjëlli i tha: »Ngjeshu dhe lidhi të mbathurat!«

Ai bëri ashtu.

Rishtas i tha: »Veshe petkun tënd dhe eja mbas meje!«

Çlirimi i Pjetrit

Pjetri doli dhe po shkonte pas tij. Nuk ishte i vetëdijshëm se ndodhja që po ngjante me anë të engjëllit ishte e vërtetë, por kujtonte se kishte një vegim. Kaluan rojën e parë edhe të dytën e arritën të dera



e hekurt, e cila çon në qytet. Kjo u hap vetvetiu e ata dolën, kaluan një rrugë e atëherë engjëlli papritmas u nda prej tij.

Atëherë Pjetri, si erdhi në vete, tha:
 »Tani me të vërtetë po e di se Zoti e paska dërguar engjëllin e vet e më nxori

nga duart e Herodit dhe prej gjithësa priste populli i hebrenjve.«

Si u mendua pakëz, u nis drejt shtëpisë së Marisë, nënës së Gjonit, që quhet edhe Mark, ku shumë të krishterë ishin bashkuar në uratë. Ky trokiti në derën e jashtme, e një shërbëtore që e kishte emrin Rozë, u afrua për të hetuar kush ishte. Si e njohi zërin e Pjetrit, prej gëzimit as nuk e çeli derën, por u kthye vrap brenda e u lajmëroi se është Pjetri mbas dere.

»Ti s'je mirë në mend!« i thanë ata, por ajo pohonte njënjë se është ai. Atëherë ata thanë: »Do të jetë, pra, engjëlli i tij!«

Pjetri vazhdonte gjithnjë të trokasë. Kur e hapën derën dhe e panë, u mrekulluan. Ai u dha shenjë me dorë të heshtonin, u tregoi se si Zoti e nxori prej burgut dhe shtoi:

»Tregoni Jakobit e vëllezërve!«

Atëherë doli e shkoi në një vend tjetër.

Kur zbardhi drita, u bë pështjellim jo i vogël ndër ushtarë: vallë, ç'u bë Pjetri?! Herodi zu ta kërkojë e, kur nuk e gjeti, pasi i mori në proçes ushtarët e rojës, dha urdhër të vriteshin. Atëherë zbriti nga Judeja në Cezare e aty zu vend.

Dërgimi në mision i Barnabës e i Saulit

Në kishën e Antiokisë kishte profetë e mësues: Barnaba, Simoni i quajtur Niger, Luci nga Cirena, Manaeni që qe edukuar bashkë me tetrarkën Herod dhe Sauli. Ndërsa një herë po kryenin shërbesën hyjnore e po agjëronin, Shpirti Shenjt tha: »M'i ndani Barnabën e Saulin, për atë vepër, për të cilën i kam thirrë.«

Atëherë, pasi agjëruan dhe u lutën, vuan duart mbi ta dhe i lejuan të shkojnë.

Ata, pra, të dërguar prej Shpirtit Shenjt, u ulën në Seleuci e, prej andej, lundruan për Qipro. Kur arritën në Salaminë, filluan të predikojnë fjalën e Hyut në sinagogat e hebrenjve.

Udhëtimi i parë misionar i Paulit

Nga Pafi lundruan e arritën në Pergë të Pamfiliës. Nga Perga shkuan në Antioki të Pisidisë. Të shtunën hynë në sinagogë dhe u ulën ndenjtur. Pas leximit të Ligjit e të Profetëve, kryekujdestarët e sinagogës dërguan ke ata t'u thonë: »Vëllezër, nëse keni ndonjë fjalë ngushëllimi për t'ia drejtuar popullit, flisni!«

Atëherë Pauli u ngrit, dha shenjë me dorë e tha:


»Vëllezër izraelë dhe ju që e droni Hyun, dëgjoni! Hyu i këtij populli, i Izraelit, i zgjodhi etërit tanë dhe këtë popull e madhëroi kur ende ishte në dheun e Egjiptit e, me dorë të pushtetshme e nxori nga dheu i robërisë. Për afro dyzetë vjetë në shkretëtirë e rrethoi me kujdes. Pastaj, mbasi i zhduki shtatë kombësi në tokën e Kanaanit, ua dha në pronë tokën e tyre: diku rreth katërqind e pesëdhjetë vjetë. Pastaj u dha Gjyqtarët — deri ke Samueli profet. Atëherë kërkuan mbretin e Hyu u dha Saulin, të birin e Kishit, prej fisit të Beniaminit, për dyzetë vjetë. Pastaj, mbasi e hoq këtë, u ngriti për mbret Davidin, për të cilin edhe dëshmoi: "Gjeta Davidin, të birin e Jeseut, njeri simbas zemrës sime, i cili do t'i çojë në vend të gjitha dëshirat e mia."

Hyu prej pasardhësve të tij, si pati premtuar, i dha Izraelit Jezusin për Shëlbues.

Burra e vëllezër, bij të Abrahamit dhe ju të tjerët që pranoni një Hy të vetëm, neve na ka qenë drejtuar kjo fjalë e shëlbimit.

Dhe ne po ju shpallim Ungjillin: premtimin që ua pati dhënë etërve na e zbuloi neve, fëmijëve tyre, duke e ngjallur Jezusin«.

Të shtunën e ardhshme rrani pothuajse



mbarë qyteti për të dëgjuar fjalën e Zotit. Kur hebrenjtë panë gjithë atë shumicë, i kapi smira, i ngucën disa gra të përshpirtshme e që ishin në shenjë e besonin në Hyun e vërtetë, po ashtu edhe burrat më me rëndësi të qytetit e kështu çuan peshë një salvim kundër Paulit e Barnabës dhe i dëbuan prej vendit të vet. Këta atëherë e shkundën pluhurin e këmbëve kundër sish dhe shkuan në Ikoni. Nxënësit mbusheshin me gëzim dhe me Shpirt Shenjt.

Po ashtu edhe në Ikoni hynë në sinagogën e hebrenjve dhe aq mirë folën sa që një shumicë e madhe hebrenjsh e paganësh e pranuan besimin. Porse hebrenjtë që nuk e pranuan besimin, i ngucën dhe i çuan

peshë paganët kundër vëllezërve. Megjithatë Pauli e Barnaba u ndalën aty për një kohë të gjatë plot guxim në Zotin, i cili e dëshmonte fjalën e hirit të vet e premtonte që nëpër duar të tyre të bëheshin mrekulli dhe shenja të çuditshme.

Banorët e qyteti u ndanë dysh: njëra pjesë ishte me hebrenj e pjesa tjetër me apostuj. Paganët e hebrenjtë me kërret e vet u bënë gati për t'i salvuar e për t'i vrrarë apostujt me gurë. Apostujt, kur morën vesh, ikën në qytete të Likaonisë: në Listër, në Derbë e në rrethina. Atje vazduan predikimin e Ungjillit.

Në Listër ishte ndenjtur një njeri i sëmurë këmbësh, i shqepët që prej krahërorit të

nënës, që kurrë nuk kishte ecur. Ai e dëgjoi Paulin duke folur. Pauli ia lëshoi sytë, pa se besonte se mund të shërohej, dhe i tha me zë të lartë:


»Ndreku në këmbë tua!«

Ai i dha vetes dhe eci.

Populli, kur pa çka bëri Pauli, bërtiti në gjuhë të Likaonisë: »Hyjnitë në trajtë të njerëzve kanë zbritur ndër ne!«

Barnabën e quajtën Zeus e Paulin Hermes, sepse fliste.

Atëherë prifti i Zeusit, tempulli i të cilit ishte para dyerve të qytetit, pruri para dyerve të qytetit mëzetër e kurorë e bashkë me qytetarë deshi t'u kushtojë fli. Kur e morën vesh apostujt, Barnaba e Pauli,



shqyen petkat e veta dhe hynë në midis të popullit duke bërë turr:

»Burra, ç' po bëni kështu?! Edhe ne jemi njerëz të vdekshëm si ju! Ne u predikojmë të ktheheni nga ato kotësi kah Hyu i gjallë, i cili krijoi qiellin e tokën, detin dhe gjithçka është në to. Në breznitë e shkuara ai i la mbarë paganët të ndjekin udhën e tyre. Megjithatë nuk e la pa e dëshmuar veten me anë të bëmirsive: u dërgoi nga qielli shi e stinë të begatshme, u mbushi me ushqime e zemrat ua mbushi me gëzime.«

Dhe duke folur kështu me mëzi e ndaluan popullin mos t'u kushtojë fli.

Ndërkaq arritën disa çifutë nga Antiochia e nga Ikonja dhe e çuan peshë popullin. E gjuan me gurë Paulin dhe e qitën zvarr jashta qytetit duke kujtuar se kishte vde-

kur. Por, kur e rrethuan nxënësit, ai u ndreq dhe hyri në qytet. Të nesërmen shkoi me Barnabën në Derbë.

Pasi e shpallën Ungjillin në atë qytet dhe, pasi bënë nxënës një numër bukur të madh, u kthyen në Listër, në Ikonja e në Antiochi. I përforconin zemrat e nxënësve të qëndrojnë në fe, sepse — thoshnin — »na duhet të kalojmë nëpër shumë të vështira për të hyrë në Mbretërinë e Hyut.« Pasi luteshin e agjëronin, secilës bashkësi i caktonin udhëheqësin dhe ia porosisnin Zotit, në të cilin kishin besuar.

Pasi e kaluan Pisidinë, erdhën në Pamfili. Mbase e predikuan fjalën në Pergë, zbritën në Atali. Aty hypën në barkë e udhëtuan për Antiochi, prej kah u nisën të porositur hirit të Hyut për veprën që kryen.

Udhëtimi i dytë misionar i Paulit

Nga Antiochia Pauli e Barnaba u kthyen përkohësisht në Jerusalemi, ku kuvendi i apostujve dhe i Kishës së parë donte t'i jepte fund një çështjeje që aq fort e trazonte bashkësinë e Galacisë: a duhet që paganët një herë të kthehen e të bëhen çifutë e pastaj të krishterë. Pauli dhe disa të tjerë ishin të bindur dhe mundoheshin t'i bindin të tjerët se paganët mund të bëhen drejtpërdrejt të krishterë. Kështu edhe u vendos nga ana e apostujve dhe e kuvendit të Jerusalemit. Kështu u zgjidh çështja: a duhet krishterimi të mbesë një sektë në judaizëm, apo të bëhet, sipas vullnetit të Jezu Krishtit, besim, religjon botor. Pasi u pru vendimi, Pauli e Barnaba u kthyen në Antiochi, ku vijuan të shpallin fjalën e Hyut.

Pas disa ditësh, Pauli i tha Barnabës: »Të kthehemi e t'i vizitojmë vëllezërit në të gjitha qytetet, ku kemi predikuar fjalën e Zotit e të shohim si janë.«


Barnaba donte të marrë me vete edhe Gjonin që quhet Mark, por Pauli s'ishte

i mendimit të marrë atë, që ishte ndarë në Pamfili e nuk kishte qenë në mision me ta. Lindi në midis të tyre një mosmarrëveshje sa që u ndanë njëri prej tjetrit: Barnaba mori me vete Markun e shkoi me barkë në Qipro. Ndërsa Pauli mori me vete Silën dhe, i porositur prej vëllezërve hirit të Zotit, e qarkulloi Sirinë e Cilicinë duke i përforcuar kishat.

Pastaj arriti në Derbë e në Listër. Kështu kaluan Friginë e Galacinë. Atëherë e kaluan Mizinë e arritën në Troadë.

Si lundruam, pra, nga Troada u filluam drejt Samotrakës e të nesërmen në Neapol e prej andej në Filipe — qytet kryesor i asaj province të Maqedonisë, i banuar prej romakësh. Në këtë qytet zumë vend disa ditë.

Një ditë, ndërsa po shkonim për t'u lutur, na takoi një robërshë që në trup kishte shpirtin e shortisë që, duke ushtruar mjeshtrinë e shortisë, zotërinjve vet u sillte shumë fitesë. Kjo shkonte pas Paulit e pas nesh e bërtiste:



»Këta njerëz janë shërbëtorët e të madhit Zot; këta ju shpallin udhën e shëlbimit!«

Bënte kështu për shumë ditë e dikur ia mërziti Paulit, ky u suall prej saj dhe i urdhëroi shpirtit: »Po të urdhëroj në emër të Jezu Krishtit, dil prej saj!«

Dhe aty për aty dual prej saj.

Kur zotërinjtë e saj panë se u humb shpresa e fitesës së tyre, i kapën Paulin e Silën e i çuan në treg para krerëve të qytetit. Duke i paraqitur para pretorëve, thanë: »Këta njerëz po na trazojnë qytetin. Janë hebrenj dhe shtrijnë doke, të cilat ne, romakët, nuk mund t'i pranojmë as nuk mund t'i zbatojmë.«

Populli u lëshua kundër sish.

Paulin e Silën i burgosin

Atëherë pretorët urdhëruan t'u hiqen të veshmet e të rrahen me frushkuj. Pasi i rrahën e i copëtuan, i qitën në burg dhe i urdhëruan rojëtarit t'i ruajë me kujdes të madh. Ky, pasi mori një urdhër të tillë, i qiti në pjesën e brendshme të burgut dhe ua futi këmbët në pranga.

Rreth mesnate Pauli e Sila luteshin duke i kënduar Hyut himne. Të burgosurit i dëgjonin. Kur, papritmas, ra një termet i rëndë aq sa u trandën themelet e burgut, përnjëherë u hapën dyert e të gjithë të burgosurve u ranë prangat. Rojëtari i burgut u zgjua e, duke parë të hapura dyert e burgut, nxori shpatën e, duke kujtuar se i kanë ikur të burgosurit, deshi të vrasë veten.

Por Pauli bërtiti me sa zë pat: »Mos e prish veten se të gjithë jemi këtu!«

Ai lypi dritën, hyri vrik brenda, ra përmbys duke u dridhur para Paulit e Silës dhe, pasi i qiti përjashta, u tha:

»Çka duhet të bëj për t'u shëlbuar?«

Ata i thanë: »Beso në Jezusin Zot dhe do të shëlbohesh ti edhe familja jote.«

Dhe i predikuan fjalën e Zotit atij dhe mbarë familjes së tij. Po atë ças të natës ai i mori, ua lau varrët e menjëherë u

pagëzua ai dhe të gjithë të tijtë. Pastaj i shtiu në shtëpi, u shtroi tryezën dhe bashkë me të gjithë anëtarët e familjes u gëzua që kishte besuar në Hyun.

Pretorët, kur zbardhi drita, dërguan liktorët t'i thonë rojëtarit të burgut: »Lëshoj ata njerëz!« Burgtari ia tregoi këto fjalë Paulit: »Pretorët kanë urdhëruar t'ju lëshoj. Dilni pra, tani e shkoni në paqë!« Por Pauli i tha:

»Botërisht na kanë frushkulluar pa na pasë gjykuar, ne, që jemi nënshtetas romakë e na kanë qitur në burg. Ase si! Por le të urdhërojnë e të vijnë vetë e të na lëshojnë!«

Liktorët i lajmëruan pretorët për këto fjalë. Prandaj ata erdhën për t'u kërkuar ndjesë, i nxorën nga burgu dhe i lutën të shkojnë prej qytetit.

Ata, si dolën prej burgut, shkuan te Lidia, i panë vëllezërit, u dhanë zemër dhe shkuan.

Pauli në Selanik

Duke udhëtuar nëpër Amfipol e Apoloni, erdhën në Selanik, ku ishte sinagoga e hebrenjve. Pauli, sipas dokës së vet, hyri aty. Për tri të shtuna rresht diskutoi me ta lidhur me Shkrim Shenjt. Ai u shtjellonte dhe u paraqiste se Mesisë i duhej të pësojë e të ngjallej prej të vdekurish.

Dhe u thoshte: »Mesia është Jezusi të cilin unë e predikoj.«

Disave prej tyre u mbush mendja dhe u bashkuan me Paulin e me Silën. Po ashtu edhe një shumicë tjetër e madhe grekësh që besonin në Hyun e vërtetë dhe jo pak gra të përmendura.

Porse hebrenjtë, të ndezur nga smira, i bënë për vete disa rrugaça të këqij tregjesh, i ngucën dhe çuan peshë qytetin duke bërtitur: »Qe, erdhën edhe këtu njerëzit që kanë çuar peshë botën. Të gjithë këta veprojnë kundër urdhërit të Cezarit! Këta pohojnë se është një mbret tjetër — Jezusi!« Kështu përzinë popullin dhe të parët e qytetit që po i dëgjonin këto fjalë.

UDHËTIMI I DYTË MISIONAR I PAULIT



Ikja nga Bereja

Atëherë vëllezërit, shpejt e shpejt, natën, i dërguan Paulin e Silën në Berejë. Apostujt, kur arritën atje, shkuan në sinagogë të çifutëve. Këta ishin më zemërmirë se sa çifutët e Selanikut. Pranuan fjalën me gatishmëri dhe për ditë e shqyrtonin Shkrimin Shenjt a është ashtu me të vërtetë. Shumë prej sish e pranuan fenë. Po ashtu

edhe prej paganësh disa gra bujare e jo pak burra.

Porse kur çifutët e Selanikut morën vesh se Pauli po e shpallte fjalën e Hyut edhe në Berejë, shkuan atje dhe e përzinë e e çuan peshë popullin edhe atje.

Vëllezërit, atëherë, shpejt e shpejt e përcollën Paulin deri në det. Sila e Timoteu zunë vend aty.

Përcjellësit e çuan Paulin në Athinë, u kthyen dhe u pranë Silës e Timoteut urdhërin të shkojnë sa më parë te ai.

Pauli në Athinë

Ndërsa Pauli në Athinë po i priste Silën e Timoteun, ishte në shpirt shumë i shqetësuar sepse e shihte qytetin plot me idhuj. Në sinagogë diskutonte me hebrenj, me ata që e nderonin Hyun e vërtetë dhe me ata që për çdo ditë i takonte në treg.

Diskutonin me të edhe disa filozofë epikurenj e stoikë. Disa thoshnin: »Çfarë dëshiron të thotë ky llafazan?«

Disa të tjerë: »Duket se është lajmërues hyjnisht së huaja!« Sepse predikonte Jezusin dhe të ngjallurit prej të vdekurish.

Atëherë morën e e çuan në Areopag dhe i thanë: »A mund ta dimë, cili është ky mësim i ri, që ti po mëson? Sepse, po na i mbush veshët me disa gjëra të huaja. Dëshirojmë ta dimë çka është fjala!«

Të gjithë athinasit dhe të huajt që banojnë aty në asgjë tjetër s'e tresin kohën se në të treguar e të dëgjuar të lajmeve të fundit.

Atëherë Pauli u ngrit në midis të Areopagut dhe tha:

»Qytetarë athinas! Po shoh se në çdo pikëpamje jeni njerëz shumë besimtarë. E njëmend, duke kaluar e vërojtur monumentet tuaja të kultit hyjnor, gjeta edhe një lter në të cilin ishte shkruar: 'Hyut të panjohur', pra, Atë që ju e nderoni pa e njohur, unë jua kumtoj.

Hyu që krijoi botën dhe gjithçka është në të, Zotëruesi i qiellit e i dheut, ai as nuk banon në tempuj të punuar me dorë të njerëzve, as nuk i shërbejnë duart e njerëzve thua se ka farë nevojë për çfardo sendi — sepse është Ai që u jep të gjithëve jetën, frymën e çdo gjë të tjetër.

Prej një njeriu krijoi mbarë rodin njerëzor që ta banojë mbarë sipërfaqen e tokës, që ta kërkojnë Hyun në çdo mënyrë që të mund ta hetonin e ta gjejnë. Ai nuk është larg asnjërit prej nesh. Sepse në Të jetojmë, lëvizim e jemi, sikurse edhe disa prej poetëve tuaj thanë:

'Jemi bijtë e tij.'

Nëse, pra, jemi rodi të Hyut, atëherë s'bën të mendojmë se Hyjnia është e ngjashme me arin, me argjendin e me gurin e punuar nga mjeshtria e arti i njeriut.

Dhe Hyu, duke mos i marrë para sysh

kohërat e padijes, tani urdhëron që të gjithë njerëzit e çdo vendi të kthehen, sepse e ka caktuar Ditën, në të cilën do ta gjykojë me drejtësi botën me anë të një Njeriu, që Ai e caktoi dhe e dëshmoi për të tillë para mbarë njerëzimit duke e ngjallur prej të vdekurish.«

Kur dëgjuan 'ngjalljen prej të vdekurish', disa e përqeshën e do të tjerë i thanë:



»Në lidhje me këtë do të dëgjojmë një herë tjetër.«

Kështu Pauli u largua prej tyre. Disa ia pëlqyen fjalën e besuan. Ndër ta qe Dionizi Areopagit, një grua me emër Damarë dhe do të tjerë me ta.

Pauli në Korint

Pastaj e lëshoi Athinën e shkoi në Korint. Për çdo të shtunë diskutonte në sinagogë dhe mendohej t'ua mbushë mendjen çifutëve e grekëve.

Kur Sila e Timoteu arritën nga Maqedonia, Pauli iu kushtua krejtësisht fjalës



dhe u dëshmonte hebrenjve se Jezusi është Mesia.

Krispi, kryetari i sinagogës, me krejt familjen e tij besoi në Zotin. Edhe shumë korintas që e dëgjonin fjalën, pranonin fenë dhe pagëzoheshin.

Kështu Pauli zu vend aty një vit e gjashtë muaj duke predikuar ndër ta fjalën e Hyut.

Letra drejtuar Selanikasve

Paulin, që iu desh të ikë në Korint, e mundonin shumë mendimet e rreziqeve që iu kërcnoshin veprës së tij në veri të Greqisë. Në njërën ndër dy Letrat e drejtuara Selanikasve ai shënon se për së shpejti do të dërgojë njërin ndër bashkëpunëtorët e vet më të parë, që t'i përforcojë e t'u japë zemër.

Nga Letra prej së cilës po nxjerrim disa pjesë shihet se lajmet që më vonë mori nga Selaniku, kishin qënë të mira.

Letra e Parë drejtuar Selanikasve është Letra më e vjetër e shën Paulit. Qe shkruar në Korint në vitin 51.

»Pauli, Silvani dhe Timoteu, kishës së selanikasve, në Hyun Atë e në Jezu Krishtin Zot.

Paçi hir e paqë!

Gjithmonë i falemi nderit Hyut për ju dhe nuk pushojmë t'u kujtojmë në uratë tona duke pasur para sysh fenë vepruese tuajën e shpresën e qëndrueshme në Zotin tonë Jezu Krishtin para Hyut, Atit tonë.

Sepse, o vëllezër të dashur prej Hyut, e dimë se jeni të zgjedhur, mbasi Ungjilli ynë nuk erdhi ndër ju vetëm me anë të Fjalës, por edhe me anë të fuqisë dhe të Shpirtit Shenjt me mbushmendje të plotë.

Të tillë, pra, sikurse e dini, kemi qënë ndër ju për ju. Ju u bëtë ndjekësit tanë dhe të Zotit duke e pranuar Fjalën me gëzim të Shpirtit Shenjt edhe pse në vësh-tirësi të madhe, kështuqë u bëtë shembull

për të gjithë besimtarët e Maqedonisë e të Akajës. Sepse prej jush, jo vetëm jehoi fjala e Zotit nëpër Maqedoni e Akajë, porse edhe feja e juaj në Hyun aq fort u përhap gjithkrah, sa që s'është nevoja të flasim për këtë gjë. Sepse ata vetë tregojnë për ne: si erdhëm ke ju, si u kthyet prej idhujsh që t'i shërbeni Hyut të gjallë e të vërtetë dhe për ta pritur nga qielli Birin e Hyut, që e ngjalli nga të vdekurit, Jezusin, i cili na shpëton nga hidhërimi i ardhshëm.

Lidhur me dashurinë vëllazërore s'është nevoja t'ju shkruaj, sepse vetë Hyu u ka mësuar ta duani njëri-tjetrin; gjë që, ju vërtet, e bëni kundrejt të gjithë vëllezërve që janë në mbarë Maqedoninë: porse, vëllezër, u nxisim që në këtë gjë gjithnjë të përparoni, të kujdeseni të jetoni në paqë, të kqyrni punët tuaja, e të punoni me duar tuaja, sikurse u kemi shkruar, që të mund të jetoni ndershmërisht kundrejt atyre që nuk janë në fe e mos ta keni nevojën e kërkujt.

Nuk duam, vëllezër, t'u lëmë në padijeni lidhur me ata që vdiqën, që mos të trishtoheni porsit të tjerët që nuk kanë shpresë. E njëmend, nëse besojmë se Jezusi vdiq e u ngjall, atëherë Hyu, patjetër, edhe ata që vdiqën, nëpër Jezusin dhe bashkë me Jezusin, do t'i marrë në lumturi.


Këtë po jua themi të bazuar në fjalën e Zotit: ne që jemi gjallë e që do të ndodhim gjallë në Ditën e ardhjes së dytë të Zotit, nuk kemi për të qenë para atyre që kanë vdekur.

Sepse vetë Zoti — kur të jepet urdhëri, në zë të kryeengjellit, ne zë të borisë së Hyut — do të zbresë nga qielli e më së pari do të ngjallen të vdekurit në Krishtin, e veç atëherë, ne që do të jemi ende në jetë, bashkë me ta kemi për të qenë marrë në re në takim me Zotin në ajr e kështu kemi për të qenë me Zotin gjithmonë.

Pra, ngushëllone njëri-tjetrin me këto fjalë.

U bëjmë lutë, vëllezër, dëgjoni ata që veprojnë në ju, që kujdesen për ju në Zotin e që ju qortojnë: çmoni e nderoni me dashuri për arsye të veprimtarisë që kryejnë ndër ju!

Jetoni në paqë me shoqishoqin! U nxisim, vëllezër, t'i qortoni ata që nuk jetojnë në rregull, jepnu zemër frikacakëve,



ndihmoni të ligshetit, jini bujarë me të gjithë! Veniani mendjen që ndokush mos t'ia kthejë ndokujt të keqen me të keqe, por gjithmonë bëni të përparojë vepra e mirë ndër ju dhe kundrejt gjithkujt.

Gëzohuni përherë!

Lutuni pa pushim!

Për gjithçka falënderohuni! Sepse ky është vullneti i Hyut në lidhje me ju në Jezu Krishtin!

Vëllezër, lutuni edhe për ne! Përshëndetni të gjithë vëllezërit me puthje shenjte!

Hiri i Zotit tonë Jezu Krishtit qoftë me ju të gjithë!»

Pauli qëndroi edhe bukur do kohë në Korint. Atëherë nëpër Efez e Cezare, zbriti në Antioki.

Udhëtimi i tretë misionar i Paulit

Nga Efezi Pauli lundroi për Cezare. Aty zbriti në tokë, shkoi në Jerusalem, përshëndeti bashkësinë e pastaj u ul në Antioki. Atje kaloi do kohë dhe rishtas u nis për rrugë. Qarkulloi tokën e Galacisë e të Frigjisë duke i përforcuar të gjithë të krishterët

Nëpër krahina të bregut detit verior Pauli pastaj u kthye në Efez. Atje shkoi në sinagogë dhe për tre muaj foli botërisht e predikoi Mbretërinë Hyut duke u munduar t'i bindte njerëzit ta pranajnë Ungjillin.

Hyu, nëpër duar të Paulit, bënte mre-

kulli të jashtëzakonshme, aq sa vënin façoleta e petka prej trupit të Paulit përmbi të sëmurë dhe prej tyre u zhdukun sëmundjet e dilnin shpirtrat e ndytë.

Këndej edhe disa çifutë — egzorciistë që endeshin andej e këndej, sprovuan ta thërrasin Emrin e Jezusit Zot përmbi ata që kishin në trup shpirtrat e ndytë.

Thoshnin: »Po u përbejmë në emër të Jezusit që e predikon Pauli.«

Këtë gjë e bënin shtatë djemtë e një farë Sceve, kryepriifti të hebrenjve. Shpirti i keq ua ktheu: »Jezusin e njoh edhe Pau-

lin e di, po ju kush jeni?» Dhe njeriu, në trup të cilit ishte djalli, u lëshua në ta, i mundi dhe, të zhveshur e të plagosur, ikën prej aso shtëpie. Dëgjuan për këtë ngjarje banorët e Efezit — çifutë e paganë — dhe të gjithë i kapi frikë e madhe dhe i dhanë lavdi Jezusit Zot.

Shumë prej asish që besuan, vinin e i rrëfenin dhe ballafaqe i tregonin veprat e veta shortie. Shumë asish që kishin ushtruar mjeshtrinë e shortisë i binin librat dhe i digjnin para të gjithëve. I çmuan dhe konstatuan se vlenin pesëdhjetë mijë drahma argjendi.

Kështu fjala e Zotit përhapej e forcohej me fuqinë e Zotit.

Letra e Paulit drejtuar Galatasve

Ndërkohë që Pauli po qëndronte në Efez — në vitin 54 ose 55, e shkroi letrën e vet të drejtuar bashkësisë së krishterë, që bashkë

me të tjerët e kishte themeluar në krahinë e Galacisë (Vap 16,6; 18,23).


Kjo është një ndër Letrat e tij të shumta të drejtuara bashkësive të ndryshme. Të gjitha këto Letra, marrë së bashku, përfshijnë më shumë se një të katërt të Besëlidhjes së re. Pëmbajnë këshille e nxitje për fe, për jetë e sjellje praktike të krishterit që e përjeton fenë.

Letra e drejtuar Galatasve, prej së cilës po marrim këto fragmente është e shkruar me frymë luftarake ku Pauli mundohet ta shpëtojë bashkësinë mos të rikthehet në judaizëm.

Pauli apostull — jo prej njerëzve as prej anës së ndonjë njeriu, por prej Jezu Krishtit e prej Hyut Atë, i cili e ngjalli Jezusin prej të vdekurish —

edhe të gjithë vëllezërit që janë me mua: kishave të Galacisë.

Po kush, o galatas të pamend, ua mori mendt, kurse para syve tuaj Jezu Krishti që përshkruar i kryqëzuar? Vetëm kaq doja ta di prej jush: a e morët Shpirtin Shenjt



në saje të veprave të Ligjit, apor pse iu bindët fesë? Po a kaq të pamendët jeni? Keni filluar me Shpirtin Shenjt e të mbaroni më trup? Po athua se kot i keni përjetuar të gjitha këto? Oh, të kishin qenë kot! Po athua se ai që u jep Shpirtin Shenjt dhe bën ndër ju vepra të mrekullueshme, i bën këto pse ju kryeni veprat e Ligjit, e jo pse e keni dëgjuar mësimin e fesë?

Jo, por sikurse me Abrahamin: »I besoi Hyut e kjo gjë iu numrua për drejtësi.«

Dinic, pra, mirë: ata që besojnë janë bijtë e vërtetë të Abrahamit.

Krishti na shpërbleu prej mallkimit të Ligjit duke u bërë ai vetë në vend tonë Mallkim, sepse rri shkruar: »Gjithkush varet në shtyllë është i mallkuar.« — që përmbi paganët të arrijë bekimi i Abrahamit në Krishtin Jezus: që Premtimin — Shpirtin Shenjt — ta marrin me anë të fesë.

Para se erdhi feja, ruhesim të ndryrë nën Ligj për fenë që do të zbulohet. Kështu, pra, Ligji ishte mbikëqyrësi ynë deri që të vinte Krishti që ne të shfajësoheshim me anë të fesë. Por qysh se erdh feja, nuk jemi më nën mbikëqyrës.

Këndej të gjithë jeni bijtë e Hyut në saje të fesë në Jezu Krishtin. Sepse, gjithsa jeni pagëzuar në Krishtin — me Krishtin jeni veshur.

Nuk ka më: hebre — grek!

Nuk ka më: skllav — i lirë!

Nuk ka më: mashkull — femër!

Të gjithë ju jeni Një në Krishtin Jezus! Nëse jeni të Krishtit, jeni pasardhësit e Abrahamit, tashëgimtarë sipas Premtimit.


Letrat e Paulit drejtuar Korintasve

Kur Pauli, në vitin 52 mbas Krishtit e lëshoi Korintin, dukej se aty e kishte lënë bashkësinë e krishterë të forcuar mirë në fe. Por, së shpejti i shkuan në vesh lajme të shumëta për grindje të mëdha midis anëtarëve të bashkësisë. Kjo gjë e bëri Paulin t'u shkruajë korintasve dy letra të forta e të gjata — më të gjatat që ai vetë shkroi. Letra e Parë e drejtuar Korintasve u shkrua në Efez në vitin 56 ndërsa e Dyta u shkrua në Maqedoni në dimër të v. 57/58.

Pauli, për vullnet të Hyut i grishur të jetë apostulli i Jezu Krishtit dhe vëllai Sosteni, kishës së Hyut që është në Korint — të shenjtëruarve në Krishtin Jezus, të grishurve të jenë të shenjtë, bashkë me të gjithë ata, që kudo e thërrasin Emrin e Jezu Krishtit, Zotit tonë dhe të tyre.

Paçi hir e paqë prej Hyut, Atit tonë, dhe prej Zotit Jezu Krisht!

U përbej, o vëllezër, pashë Emrin e Zotit tonë Jezu Krishtit: të jeni të gjithë një mendimi e mos të ketë përçarje ndër ju, por jini në përkim të plotë në ndjenja e në mendime. Sepse, vëllezër, Klajtë më vënë në dijëni në lidhje me ju se midis jush ka grindje. Po spjegohem: secili prej jush thotë: 'Unë jam i Paulit!' 'Unë jam i Apolonit!' 'Unë jam i Kefës!' 'Unë jam i Krishtit!' Vallë a qenka ndarë Krishti?! A mos u kryqëzua Pauli për ju? Vallë a u pagëzua në emër të Paulit? Faleminderës Hyut që, me përjashtim të Krispit, s'pagëzova asnjë ndër ju, që ndokush mos



Sepse thotë Shkrimi shenjt:

'Do ta shqymi dijen e të dijshtëmve,
larg do ta flaki urtinë e të urtëve.'

Ku është i dijshtëmi? Ku është mësuesi i Ligjit? Ku është shqyruesi i kësaj bote? Po Hyu a nuk e bëri marri urtinë e botës? E njëmend, pasi bota me dijen e Hyut nuk e njohi Hyun me anë të dijes, i pëlqeu Hyut, me marrinë e predikimit, t'i shëlbojnë besimtarët. Sepse hebrejtë kërkojnë shenja e grekët urti, ne predikojmë Krishtin e kryqëzuar — për çifutë shkan dull e për grekë marri, por për të grishurit — si çifutë si grekë — Krishtin, fuqinë e Hyut e dijen e Hyut, sepse marria e Hyut është më e dijshtëme se njerëzit e dobësia e Hyut më e fuqishme se njerëzit.

Roli i apostujve

Pra, unë mendoj se Hyu ne apostujve na ka vënë në vendin e fundit si të ishin të dënuar për vdekje: lojë për botën, për engjëjt e për njerëzit — ne të marrë për shkak të Krishtit, ju të urtë në Krishtin; ne të dobët, ju të fortë; ju të nderuar e ne të përbuzur.

Deri tani jemi unshëm e jemi etshëm, jemi të zhveshur e të nëpërkëmbur, të pa plang e të pa shtëpi e lodhemi duke punuar me duar tona. Na shajnë e ne flasim mirë për ta, na salvojnë e ne durojmë; na shpifin e ne ngushëllojmë. U bëmë deri më sot porsit plehurat e botës, porsit të fshirat e gjithkujt.

Nuk po jua shkruaj këto që t'ju turpëroj, por që, sikurse fëmijët e mi të dashur, t'u qortoj. Sepse edhe po t'i kishit dhjetë mijë edukatorë, nuk do të kishit shumë etër. Sepse me anë të Ungjillit vetëm unë u lindi në Jezu Krishtin. Çka më tepër dëshironi: të vij te ju me thupër a por me dashuri e me shpirt butësie?

Dhuratat janë të ndryshme, por Shpirti Shenjt është një i vetëm — i njëjtë; edhe shërbesat në përhapje të Ungjillit janë të ndryshme, por Hyu është një i vetëm, i njëjtë; Ai që bën gjithçka në të gjithë.

Secili merr dhuratë të veçantë të zbulesës së Shpirtit Shenjt për të mirën e përbashkët.

E njëmend Shpirti Shenjt i jep njërit

fjalën e urtisë, ndërsa i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fjalën e dijes; po i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fenë, një tjetri prapë, i njëjti Shpirt Shenjt, dhuratën e shërimeve, një tjetri pushtetin të bëjë mrekulli, një tjetri profecinë, një tjetri aftësinë të dallojë shpirtrat, një tjetri zotësinë e gjuhëve të ndryshme, një tjetri shtjellimin e gjuhëve. E të gjitha këto i bën një i vetmi Shpirt Shenjt duke i ndarë secilit veçanërisht ashtu si ai do.

Një trup i vetëm e shumë gjymtyrë

E njëmend sikurse një trup i vetëm ka shumë gjymtyrë, e të gjitha gjymtyrët e trupit edhe pse shumë — nuk formojnë por një trup të vetëm — ashtu Krishti: e njëmend, në një të vetmin Shpirt Shenjt të gjithë jemi pagëzuar për të qenë një trup i vetëm si hebrejtë ashtu grekët, si robërit ashtu të lirët dhe të gjithë e kemi shuar etin në të njëjtin Shpirt Shenjt.

Sepse trupin nuk e përbën vetëm një gjymtyrë, por është i përbërë prej shumë gjymtyrësh. Po bëri e tha këmba: 'pasi nuk jam dorë — nuk jam pjesë e trupit' athua njëmend nuk do të jetë pjesë e trupit? Po bëri e tha veshi: 'Pasi nuk jam sy — nuk jam pjesë e trupit — athua njëmend nuk do të jetë pjesë e trupit? Po të ishte tërë trupi sy, ku do të ishte dëgjimi? Po të ishte krejt vesh, ku do të ishte shqisja e të nuhaturit? Kështu Hyu i ka caktuar gjymtyrët, çdonjërin në trup sikurse ka dashur. Po të ishin të gjitha një gjymtyrë e vetme, ku do të ishte trupi? Kështu pra, shumë gjymtyrë, por vetëm një trup. Syri s' mund t'i thotë dorës: 'S'kam nevojë për ty'ose kryet këmbëve: 'Nuk kam nevojë për ju!' Madje, ato gjymtyrë të trupit që duket se janë më të ligështa, janë më të nevojshme. Dhe, nëse vuan një gjymtyrë, vuajnë së bashku të gjitha gjymtyrët; e, nëse nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të.

Tashti ju të gjithë së bashku jeni trupi i Krishtit e një nga një gjymtyrët e tija.

Kështu Hyu disa në Kishë i caktoi: më së pari apostujt, së dyti profetët, së treti mësuesit; pastaj vjen dhurata e mrekullive, pastaj ajo e shërimeve, e kujdesimit me



të mund të thotë se u pagëzua në emër tim. E po, paskam pasë pagëzuar edhe familjen e Stefanës. Për sa më kujtohet, të tjerë nuk kam pagëzuar. Sepse Krishti nuk më dërgoi të pagëzoj, por të predikoj Ungjillin, madje jo me dituri fjale që mos të dalë i kotë kryqi i Krishtit.

E njëmend, biseda për kryqin, për ata që biren, është marri, ndërsa për ne të shpëtuarve, është fuqia e Hyut.

ndarje ndihmash, e drejtimit shpirtëror, dhurata e gjuhëve të ndryshme.

Athua të gjithë apostuj? Të gjithë profetë? Të gjithë mësues? Athua të gjithë duhet të bëjnë mrekulli? Athua të gjithë duhet të kenë dhuratën e shërimeve? Athua të gjithë flasin gjuhët? Të gjithë spjegojnë?

Dëshironi dhuratat më të lartat.

Dhe, ja, po ju dëftoj udhën më të shkëlqyeshmen!

Udha më e mira

Po t'i folja gjuhët e njerëzve e të
engjëjve,

por mos ta kisha dashurinë,
do të isha pors bronzi që kumbon
e pors cimbali që tingëllon.
Po ta kisha dhuratën e profecisë
e t'i dija të gjitha misteret
e të gjitha dijenitë;

po ta kija edhe fenë e plotë
me të cilën të mund t'u shndërroja vend
maleve,

por po të më mungonte dashuria,
do të isha asgjë!

Po ta ndaja lëmoshë mbarë pasurinë
time
dhe po ta jepja trupin tim të digjej për
pendesë,

por po të më mungonte dashuria,
nuk do të më vlente asgjë.

Dashuria është zemërgjërë,
është e dhimbshme,

nuk ka smirë,
nuk mbahet në të madh,
nuk krenohet.

Nuk është e panjerëzishme,
nuk kërkon interesin e vet,
nuk hidhërohet,
s'e mba në mend të keqen,
nuk i kënaqet padrejtësisë,
por i gëzohet së vërtetës.

Arsyeton gjithçka,
beson gjithçka,
shpreson gjithçka,
duron gjithçka.

Dashuria nuk mbaron askurrë!

Profecitë do të mbarojnë.

Gjuhët do të pushojnë.

Njohuritë do të mbarojnë.

Sepse njohuria jonë është e kufizuar
dhe e kufizuar është profecia jonë.

Por kur të arrijë përsosmëria,
çka është e kufizuar do të marrë fund.

Kur isha fëmijë,
folja si fëmijë,
mendoja si fëmijë,

arsyetaja si fëmijë.

Kur u bëra njeri i pjekur,

flaka tej çka i përket fëmijërisë.

Vërtet, tani shikojmë si në psaqyrë e në
mënyrë të errët,

por atëherë do të shohim faqe-faqas!
Tani njohuria ime është e kufizuar,
atëherë do të njoh plotësisht
sikurse edhe jam i njohur (prej Hyut).
Tani mbetet feja, shpresa e dashuria
— këto të trija —
porse më e madhja ndër to është
dashuria.»

Letra e Krishtit

»Athua rishtas po fillojmë ta porosisim
vetveten? Athua kemi nevojë për letra po-
rosie për ju e prej jush si disa? Letra
jonë jeni ju, e shkruar në zemrat tona,
të cilën e njohin dhe e lexojnë të gjithë
njerëzit! Sepse ju e tregoni se jeni Letra
e shkruar prej Krishtit, të cilës ne i shër-
byem, e shkruar jo me ngjyrë, por me
Shpirt të Hyut të gjallë, jo në rrasa guri,
por në rrasa mishi të zemrës.

E kemi këtë bindje nëpër Krishtin në
Hyun, jo sikur të ishim vet të zotët prej
vetvetes të mendojmë gjë, por zotësia jonë
e ka burimin e vet në Hyun. Ai na bëri
të aftë të jemi mbarështues të Besëlidhjes
së re, jo të shkronjës, por të Shpirtit, sep-
se shkronja vret ndërsa Shpirti jep jetën.

Zoti është Shpirti. Aty ku është Shpirti
i Zotit, është liria. E ne të gjithë, të cilët,
me fytyrë të zbuluar, bredhin si pasqyra
lavdinë e Zotit me anë të Shpirtit të Zotit,
shndërrohemi po në atë figurë, përherë e
më të lavdishme, sepse na vjen prej Zotit,
prej Shpirtit.»

Argjendari shkakton kryengritjen

Disi në atë kohë ndodhi një rrëmujë
jo e vogël kundër fesë në Efez. Një ar-
gjendar, që quhej Dhimitër, punonte tem-
pui të vegjël të Artemidës dhe kështu u
sillte fitesë jo të vogël mjeshtrave. Ky i
bashkoi këta dhe të gjithë të tjerët që merre-
shin me këtë veprimtari dhe u tha:

»Burra, ju e dini se fitesa jonë varet
nga kjo mjeshtri, e ju po shihni se ky,
Pauli, jo vetëm në Efez, por edhe në mbarë
pothuajse Azinë, ia ka mbushur mendjen
dhe e ka larguar një shumicë të ma-
dhe populli duke mësuar se nuk ka hyjni



të punuara me dorë njeriu. Kështu, jo ve-
tëm se është në rrezik mjeshtria jonë, por
edhe tempulli i Artemidës, hyjneshës së
madhe, s'ka për t'u çmuar më e do të
mbarojë lavdia e saj, të cilën e nderon
krejt Azia e bota mbarë.»

Kur dëgjuan, u hidhëruan dhe filluan të
bërtasin: »E madhe është Artemida e Efe-
zit!« Pështjellimi zotëroi mbarë qytetin. U
lëshuan të gjithë së bashku në teatër, duke
i marrë zvarr maqedonët, Gajin e Aris-
tarkun, bashkudhëtarët e Paulit. Pauli vetë

deshi të paraqitej para popullit, por nuk
ia lejuan nxënësit. Madje edhe disa aziarkë,
miq të tij, çuan njerëz te ai e iu lutën
mos të duket në teatër.

Disa bërtisnin një send, do të tjerë një
tjetër: mbledhja ishte pështjelluar plotësisht,
aq sa shumë prej sish as pse kishin shku-
ar atje s'dinin më. Disa prej popullit ia
mbushën mendjen të flasë një farë Alek-
sandri, të cilin hebrenjtë e nxitnin të dalë
para mbledhjes. Aleksandri dha shenjë me
dorë e deshi të mbrohej para popullit.



Kur e morrën vesh se ishte hebre, të gjithë një zëri zunë të bërtasin pa pushuar për dy orë: »E madhe është Artemida e Efezit!«

Atëherë sekretari i qytetit ia dual ta qetësojë popullin e tha: »Burra të Efezit! Cili njeri nuk e di se qyteti i Efezit është rojësi i tempullit të Artemidës së madhe dhe i trupores së saj që ra nga qielli? Pra, mbasi kjo gjë s'mund të mohohet, duhet të qetësoheni që mos të bëni ndonjë veprim për ngut. I prutë këta njerëz, që s'janë as vjedhës të gjërave të shenjta as s'e kanë blasfemuar hyjneshën tonë. Po qe se Dhimitri dhe mjeshtrit e tij kanë ndonjë ankesë kundër kujt, gjyqet punojnë

e këtu janë edhe prokonsujt: le të paditen! Nëse kërkoni ndonjë send tjetër, do t'i jepet fund në kuvend të rregullt. Sepse kështu e vëmë veten në rrezik të na çmohet kjo ngjarje e sotme kryengritje, pasi s'kemi kurrëfarë arsyeje, me anë të cilës mund ta përlijim këtë pështjellim.«

Si foli kështu e shpërndau kuvendin.

Pasi u paqëtua turbullimi, Pauli i thirri nxënësit, u dha porosinë, i përshëndeti dhe u nis për Maqedoni. Pasi i qarkulloi ato vende dhe u mbajti fjalime të shumta, arriti në Greqi dhe ndenj aty tre muaj. Shi kur mendoi të udhëtojë me barkë për Siri, çifutët i vunë pritën, ai atëherë ven-

dosi të kthehet nëpër Maqedoni. E përcillnin Sopatri, i biri i Pirrit, nga Bereja, Aristarku e Sekundi, nga Selaniku, Gaji prej Derbit e Timoteu; dhe prej Azisë Tihiku e Trofimi. Këta shkuan para nesh e na pritën në Troadë. Ne, si kaluan ditët e Bukëve të pabruara, lundruam nga Filipi dhe, pas pesë ditësh, arritëm te ta në Troadë. Atje ndenjëm shtatë ditë.

Eutihi rrëxohet nga i treti kat

Ditën e parë të javës (e diel), kur u mblodhëm të ndajmë Bukën, Pauli u pre-

dikonte e, mbasi të nesërmen mendonte të udhëtojë, bisedoi deri në mesnatë. Në dhomën e sipërme, ku ishim të bashkuar, kisim shumë llamba.

Një djalosh, që quhej Eutih, ishte ulur në dritare. E kapi gjumi e ashtu në gjumë, i iku shtati e ra prej katit të tretë poshtë. E ngritën të vdekur. Pauli u ul poshtë, u afrua, e mori djaloshin para duarsh e tha: »Mos u shqetësoni, nuk ka vdekur.« Atëherë u ngjit lart e, pasi e ndau Bukën dhe pasi ngrëni, vazhdoi të flasë edhe për një kohë të gjatë, deri në agim. Atëherë u nis. Djaloshin e çuan gjallë në shtëpi me gëzim të pa masë.

Letra e shën Paulit apostull drejtuar bashkësisë në Romë

Pauli gjithëherë ka pasur dëshirë ta vizitojë Romën, kryeqytetin e famshëm të perandorisë aq të fuqishme. Që më parë i gëzohej këtij udhëtimi, prandaj edhe vendosi t'ia shkruajë bashkësisë së krishterë një letër. Kështu në fillimin e viti 58. ia drejtoi nga Korinti letrën e rëndësishme bashkësisë së krishterë që ishte që më parë e themeluar. Këtë udhëtim e kishte në plan ta ndër-marrë posa ta kryente misionin që kishte në Jerusalem. Planin ia penguan rrethanat, që më vonë i takuan, të cilat, kur shkroi letrën, nuk ishte në gjendje t'i parashohë.

»Të gjithëve në Romë, të dashurve të Hyut, të grishurve, shenjtërve:

Më së pari i falem nderës Hyut tim nëpër Jezu Krishtin për ju të gjithë: sepse për fenë tuaj po hapet nëpër mbarë botën një zë i mirë. Hyun, të cilit i shërbej me gjithë shpirt duke shpallur Ungjillin e të Birit të tij, e kam dëshmitar se vazhdimisht ju kujtoj duke kërkuar pandarë me uratë ta kem dikur fatin-simbas vullnetit të tij — të vij një ditë ndër ju. E njëmend, kam dëshirë të madhe t'ju shoh për t'u dhënë ndonjë dhuratë shpirtërore që të forcoheni — ose më mirë — që së bashku me ju e ndër ju edhe unë të nxehem në fe, që e kemi të përbashkët, të tuajën e të timen.«

Dashuria hyjnore

»Vëllezër, nuk dua mos ta dini: shumë herë kam dashur të vij ndër ju — por deri tani qesh i penguar — për të korrë ndonjë fryt edhe ndër ju sikurse edhe ndër popujt e tjerë. E ndiej veten të detyruar kundrejt grekëve e barbarëve, kundrejt të përparuarve e të prapambeturve. Këndej, pra, dëshira ime t'ju shpall Ungjillin edhe juve në Romë.«

Lutuni që të mund të vij te ju

»Pasi ta kem kryer këtë punë — t'ua kem dorëzuar zyrtarisht këtë dhuratë — do të nisem për Spanjë e, në kalim, te ju.

E di se kur të vij ke ju do të vij plot me bekime të Krishtit. Prandaj u përbej, vëllezër, pashë Jezu Krishtin, Zotin tonë e dashurinë e Shpirtit Shenjt, luftoni bashkë me mua me uratë që për mua ia drejtoni Hyut, të më shpëtojë prej të pafeve të Judesë dhe që ndihma ime t'u pëlqejë të krishterëve; që të vij te ju plot hare e me vullnet të Hyut të pushoj bashkë me ju.

Hyu, autori i paqës, qoftë me ju të gjithë. Amen.«

Pauli nxiton të shkojë në Jerusalem

Pauli nxitonte sepse dëshironte të gjendej për Rrëshajë në Jerusalem. Nga Troja, nëpër As lundroi për Kios, Sam, zu vend për pak kohë në Milet, u përshëndet me Efzazas e, nëpër Kos e Rod, shkoi në Tir, e atëherë në Cezare. Bashkudhëtari i tij, Luka na tregon:

Pasi ndenjëm aty për shumë ditë, prej Judesë zbriti aty një profet me emër Agab. Ky erdhi ndër ne, mori brezin e Paulit, lidhi këmbët e duart e veta e tha:

»Kështu thotë Shpirti Shenjt: Njeriun, brezi i të cilit është ky, hebrenjtë do ta lidhin njëkështu në Jerusalem dhe do ta dorëzojnë paganëve.«

Kur i dëgjua këto, si ne ashtu edhe vendasit, zumë t'i lutemi Paulit mos të ngjitej në Jerusalem. Pauli na përgjegji:

»Pse po qani e po ma copëtoni zemrën? Jo po, unë jam gati jo veç të më lidhin, por edhe të vdes në Jerusalem për shkak të Emrit të Jezusit Zot.«

Pasi s' mund t'ia mbushnin mendjen, s'iu vumë më e thamë: »U bëftë vullnesa e Zotit.«



Pas këtyre ditëve, u bëmë gati dhe u ngjitëm në Jerusalem. Bashkë me ne erdhën edhe disa nxënës nga Cezareja dhe na çuan në shtëpinë e një farë Mnasoni.

Kur arritëm në Jerusalem, vëllezërit na pritën me gëzim.

Të nesërmen Pauli me disa hebrenj kreu ritin e pastrimit, hyri në Tempull, shpalli mbarimin e ditëve të kushtit, pas të cilave duhej të kushtohej flia për secilin prej tyre.

Paulin e arrestojnë në Jerusalem

Kur shtatë ditët po merrnin fund, disa hebrenj prej Azisë e hetuan Paulin në Tempull, çuan peshë mbarë qytetin dhe e kapën

duke bërë titur: »Burra izraelas, në ndihmë! Ky është ai njeri që gjithkund mëson gjithkë kundër popullit tonë, kundër Ligjit dhe kundër këtij Vendi. Përmëtepër i ka futur në Tempull edhe paganët e e ka dhunuar këtë Vënd të shenjtë.«

Sepse ata e kishin parë në qytet Trofinin prej Efezit bashkë me të e mendonin se Pauli do ta ketë pasur edhe në Tempull.

Mbarë qyteti u përzi e populli rrani prej çdo ane. E kapën Paulin dhe e nxorën përjashta Tempullit dhe menjëherë u mbyllën dyert. Ndërsa ata po donin ta vrasin, shkoi lajmi te tribuni i kohortës se mbarë Jerusalemi është ngritur në kryengritje. Ai menjëherë mori ushtarët e centurionët e shkoi ndër ta. Këta, kur e panë tribunin e ushtarët, zunë vend të rrahin Paulin.

Atëherë tribuni u afrua e kapi dhe urdhëroi të lidhet me dy parë hekura. Pastaj zu të pyesë kush është dhe çka ka bërë. Prej turmës veç, dikush bërtiste një gjë dikush një tjetër, e meqenëse prej zhurmës s'mund të merrte vesh asgjë të sigurtë, dha urdhër të çohesh në kështjellë. Kur Pauli kapi shkallat u desh që ushtarët ta mbanin para duarsh për shkak të sulmit të popullit; sepse turma e popullit i shkante mbas e bërtiste: »Vraje!«

Pauli mbrohet

Pauli, shi kur ishte duke hyrë në kështjellë, i tha tribunit: »A kam leje të them diçka?«

Ai i përgjegji: »Po a di ti greqisht? Po a nuk je ti ai egjiptiani që para disa ditësh çoi në kryengritje dhe i mori pas vetes në shkretëtirë ata katër mijë thikëtarë?«

Pauli i përgjegji: »Unë jam hebre nga Tarsi i Cilicisë, qytetar i qytetit të përmendur. Po të lutem, më lejo t'i them këtij populli dy fjalë.«

Kur komandanti e lejoi, Pauli prej shkallave i bëri me dorë popullit e, kur u bë heshtim i plotë, foli në gjuhë hebraishte:

»Vëllezër dhe etër! Më dëgjoni çka tani do t'ju them në mbrojtjen time.«

Kur dëgjuan se po u fliste në gjuhë hebraishte, heshtimi u bë shumë më i thellë. Ai vazhdoi:

»Unë jam hebre i lindur në Tarsin e Cilicisë, por u rrita në këtë qytet, te këmbët e Gamalielit, i edukuar mbas Ligjit të të parëve isha zelltar i Hyut, shi sikurse jeni ju edhe sot e kësaj ditë. Këtë Fe e kam salvuar deri në vdekje, i kam qitur në pranga dhe kam burgosur burra e gra, si mund të ma bëjë dëshmi edhe kryepifti dhe e gjithë parësia. Prej sish kam marrë edhe letrat për të burgosur vëllezërit në Damask dhe u nisa që edhe ata atje t'i bie të lidhur në Jerusalem për t'i ndëshkuar.«

Pastaj e tregoi historinë e kthimit të vet në krishterim, të pagëzimit dhe të misionit. Theksoi se si një herë Zoti në një vegim i tha: »Shko se do të çoj larg, ndër paganë!«

Çifutët e dëgjuan deri këtu. Në këto fjalë filluan të bërtasin: »Zhduke prej faqes së dheut një njeri të tillë! Ky s' meriton të jetojë!«

E zunë të bërtasin të madhe, të hedhin me petka e të qesin pluhur në ajr. Atëherë tribuni urdhëroi të shtihet Pauli në kështjellë dhe urdhëroi ta bëjnë të flasë me frushkuj që ta merrte vesh pse ashtu bërtisnin kundër tij.

Pauli thirret në të drejtën e vet të qytetarit romak

Kur ushtarët po e lidhnin me rripa për ta frushkulluar, Pauli i tha centurionit që ishte pranë:

»Athua keni leje ta rrahni frushkuj qytetarin romak, madje edhe të pagykuar akoma?«

Centurioni, kur i dëgjoi këto fjalë, iu afrua tribunit e i tha: »Çka mendon të bësh? Ky njeri është romak!«

Tribuni iu afrua dhe e pyeti: »Më trego, a je ti romak?«

Pauli i përgjegji: »Po!«

Tribuni i tha: »Unë e kam blerë shtrejt këtë nënshtetësi.« Pauli i përgjegji: »E unë kam lindur në të!«

Kënde vrik u larguan prej tij ata që do ta merrnin në proçes. Po edhe tribunit i hyri frika kur e mori vesh se ishte romak e ai e kishte lidhur në pranga.


Të nesërmen tribuni, duke dashur të dijë pikërisht të vërtetën — domethanë përse hebrenjtë e padisnin, e zgjidhi, dha urdhër të mblidhen kryepriftërinjtë e mbarë Këshilli i lartë në kuvend, urdhëroi të bihet edhe Pauli dhe e ballafaqoi me ta.

Pasi zhurma shkante duke u rritur, tribuni filloi të frikësohej mos po e kapin Paulin e po e copëtojnë, prandaj urdhëroi të ulet ushtria, ta marrë prej mesit të tyre e ta çojë në kështjellë.

Natën pas Zoti iu duk Paulit e i tha: »Aspak mos u tremb, si ke dëshmuar në Jerusalem për mua, ashtu duhet të dëshmosh edhe në Romë.«

Komploti kundër jetës së Paulit

Kur zbardhi drita, disa hebrenj u përbe-tuan se as s'do të ngrënin as s'do të pinin



pa e pasë vrarë Paulin. Ata që e bënë këtë përbetim, ishin më tepër se dyzetë vetë. Shkuan ke kryepfritërinjtë e krerët e popullit dhe u thanë:

»Me përbetim u përbetua të mos kërkojmë asgjë me gojë para se ta vrasim Paulin. Këndej ju, bashkë me Këshill, paraqitnia tribunit ta bjerë atë para jush se dëshironi ta shqyrtoni më mirë çështjen e tij e ne jemi gati ta vrasim para se ai të mbërrijë.«

Por për komplot dëgjo i biri i motrës së Paulit, shkoi e hyri në kështjell për t'i treguar Paulit. Pauli thirri një centurion dhe i tha: »Përcille këtë djalosh ke tribuni; ka diçka t'i thotë!« Ky e mori dhe e çoi te tribuni.

Pasi djaloshi i tregoi çdogjë, atëherë tribuni e nisi djaloshin dhe i urdhëroi:

»Askujt mos i trego se më ke sjellë këtë lajm.«

Atëherë tribuni grishi dy centuariona e u tha: »Bëni gati dyqind ushtarë, shtatëdhjetë kalorës e dyqind shigjetarë që me tri orë natë të nisen për Cezare. Le të bëhet gati shtaza në të cilën të udhëtojë Pauli e të çohet shëndosh te Feliksi, qeveritari.«

Atëherë ushtarët, pas urdhërit që morën, e morën Paulin natën e e çuan në Antipatridë.


Paulin e qesin para qeveritarit Feliks

Pas pesë ditësh zbriti Anania, kryepfriti, me disa pleq dhe me një avokat që quhej Tertul dhe ia paraqitën qeveritarit padinë kundër Paulit. Kur e prunë Paulin, atëherë Tertuli zu ta akuzojë:

»Kemi konstatuar se ky njeri është një murtajë dhe se e nxit popullin hebre gjithkund nëpër botë në kryengritje dhe se është udhëheqësi i Nazarenëve. Ky u mundua ta dhunojë edhe Tempullin, por atëherë e zumë. Edhe prej tij, nëse do ta pyetësh, do të mund t'i kuptosh të gjitha për çka ne e padisim.« Hebrejntë e përkrahën duke pohuar se puna qëndron ashtu.

Kur qeveritari i dha fjalën Paulit, ai përgjigji:

»Nuk më gjetën as në Tempull as në sinagoga duke diskutuar me ndokënd as du-



ke nxitur në kryengritje dhe nuk janë në gjendje ta vërtetojnë atë gjë për të cilën më padisin tani. Përkundrazi pohoj këtë gjë: me Fenë të cilën këta e quajnë sektë, unë i shërbej Hyut të etërve duke besuar gjithçka është të shkruar në Ligj e në Profetë.«

Feliksi që e njohte mjaftë mirë këtë fe, e shtyu çështjen me këto fjalë: »Kur të

vijë vetë tribuni, Lizia, do t'i jap fund çështjes së tuaj.« Centurionit i urdhëroi të ruhej Pauli me rojtarë, por duke i lënë disa liri si edhe mos t'i ndalohej askujt prej të tijvet t'i bëjnë ndonjë shërbim.

Pas dy viteve Feliksin e zëvendësoi Ponci Fest. Feliksi, duke dashur të tregojë dashamirë kundrejt hebrejve, e la Paulin në pranga.

Pauli apelon në Cezarin

Festi u ul në Cezare, ndenj në selinë e gjykatores dhe urdhëroi të sillet Pauli në gjykatore. Kur ky erdhi e rrethuan hebrejntë që ishin ulur nga Jerusalemi dhe bënë kundër tij padi të shumta e të rënda, të cilat veç s'ishin në gjendje t'i vërtetojnë. Pauli u mbronte: »Kurrëfarë faji nuk kam

bërë as kundër Ligjit të hebrenjve, as kundër Tempullit as kundër Cezarit.»

Atëherë Festi, duke dashur t'ua plotësonte dëshirën hebrenjve, i tha Paulit: »A do të ngjitesh në Jerusalem e atje të gjykoresh për këtë punë para meje?«

Pauli i përgjegji: »Qëndroj para gjykatores së Cezarit, ku duhet të gjykohem. Hebrenjve s'u kam bërë farë faji sikurse edhe ti e di fare mirë; e, nëse kam bërë ndonjë krim që meriton vdekjen, nuk i iku vdekjes; e nëse s'janë të vërteta paditë e tyre, askush s'ka të drejtë të më japë në duar të tyre. Apeloj në Cezarin!«

Atëherë Festi, pasi u këshillua me këshilltarët e vet, përgjegji: »Apelove Cezarin, ke Cezari do të shkosh.«

Paulin e qesin para mbretit Agripë

Pasi kaluan disa ditë, në Cezare erdhën mbreti Agripë dhe Berenika për ta përshëndetur Festin. E, pasi aty qëndruan për disa ditë, Festi ia zuri në gojë mbretit çështjen e Paulit.

Agripa i tha Festit: »Dëshiroj ta ndëgjoj edhe unë këtë njeri.«

»Nesër do të kesh rast ta dëgjosh.« — i tha Festi.

Ditën e nesërme erdhën Agripa e Berenika me shkëlqim të madh dhe hynë në sallën e pritjes bashkë me tribuna e me njerëz të zgjedhur të qytetit. Në urdhër të Festit e sollën edhe Paulin. Festi tha:

»Mbret Agripë dhe ju të gjithë që jeni këtu pranë me ne, shikone këtë njeri, për shkak të cilit populli hebre ka kërkuar prej meje e në Jerusalem e këtu duke bërë titur se ky njeri s'duhet të jetojë më! Por unë jam plotësisht i bindur se nuk ka bërë asgjë që të meritojë vdekjen e, pasi ai vetë kërkoi të dalë në gjyq para Lartëmadhërisë, vendosa ta dërgoj. Unë nuk kam asgjë të sigurtë çka t'i shkruaj Zotërisë për të. Prandaj edhe e qita para jush, sidomos para Teje, Mbreti Agripë, që pas këtij procesi, të kem çka t'i shkruaj. E njëmend, më duket krejtësisht e paarsyeshme, të dërgoj të burgosurin e mos ta shënoj padinë kundër tij.«

Pasi Agripa i dha leje të mbrohej, Pauli mbajti një fjalim aq të thekshëm mbi jetën

e vet, mbi kthim në krishterim e, sidomos mbi fenë dëshmuese të veten për të ngjallurit e Jezu Krishtit, sa që Agripa i përgjegji:

»Për pak e po ma mbush mendjen se më bërë të krishterë!«

E Pauli: »E bëftë Hyu që, o për pak o për shumë, dhe jo vetëm ti, por edhe të gjithë këta që po më dëgjojnë sot, të bëhen shi si jam unë... me përjashtim veç të këtyre pangave që mbaj.«



Atëherë u ngritën mbreti, sundimtari, Berenika dhe ata që kishin marrë pjesë me ta në mbledhje. Duke u shpërndarë i thoshnin njëri — tjetrit: »Ky njeri s'bën asgjë që të meritojë vdekjen ose prangat.«

Agripa i tha Festit: »Ky njeri do të mund të lirohej, po mos të kishte kërkuar të gjykohej para Cezarit.«

Udhëtimi i Paulit për Romë

Kur u pru vendimi të udhëtojmë për Itali, Paulin dhe disa të burgosur të tjerë ia dhanë në dorëzim një centurioni që quhej Jul që ishte prej togës Auguste. Hypëm, pra, në një anije adramitine, e cila do të lundronte përngjat limaneve të detit të Azisë dhe u nisëm. Të nesërmen arritëm në Sidon. Juli, që sillej njerëzisht me Paulin, i dha leje të shkojë ndër miq që të kujdesen për të. Prej andej morëm detin e lundruam përngjat Qipros, sepse i kishim erërat e kundërta — dhe kaluam detin për ngjat Cilicisë e Pamfilisë e arritëm në Mirën e Licisë. Këtu centurioni gjeti një anije nga Aleksandria që udhëtonte për Itali dhe na ngarkoi në të.

Për shumë ditë udhëtimi ishte i ngadalshëm e me mëzi arritëm në Knid. E, mbasi era nuk na lejoi të ndalet anija në port, vazhduam për nën Kretë, në anë të Salmonës e me mëzi arritëm në një vend që quhet »Limamet e mira« përngjat qytetit të Lasejës.

Pasi kishte kaluar shumë kohë e lundrimi ishte bërë i rrezikshëm — sepse Agjërimi i madh kishte kaluar — Pauli i këshillonte e u thonte:

»Burra, unë shoh se lundrimi do të dalë me vështirësi e me dëm të madh, jo vetëm për barrë e për anije, por edhe për jetën tonë.«

Stuhia në det


Porse centurioni më fort i besonte timonierit dhe të zot të anijes se sa vërejtjeve të Paulit. E, mbasi porti nuk ishte i përshtatshëm për të kaluar dimrin, shumica propozuan të nisen prej andej me shpresë që si do të munden ta kapnin Feniksin,

një port të Kretës që është i çelur nga jugperëndimi e veriperëndimi e aty ta kalojnë dimrin.

Ndërkaq çoi një puih e lehtë shiroku, ata pleqëruan se ky mendim mund të realizohej, hoqën spirancën dhe lundruan për anë të Kretës. Por mbas pak kohe, u tërbua një erë e fortë që quhet eura-kulon (murrlla). Ania, e rrëmbyer, u bë e paaftë t'i qëndrojë erës; ne u lëshuam të na hedhë andej e këndeje. Duke lundruar në straherën e një ishulli të vogël që quhet Kauda, me mëzi mundëm ta kapim sandallin e shpëtimit. E kapën, e përdorën konopët e spirancës për ta ngjeshur anijen. Prej frikës mos të mbesim në zallë, në Sirtë, e ulën velin. Kështu mbaheshim andej e këndeje. Pasi stuhia na rrahte me tërbim, të nesërmen hodhën mallrat në det e, të tretën ditë, me duar të veta hodhën vegla e pajisje anijeje. Për shumë ditë nuk u pa dielli as yjet e stuhia tërbohej gjithënjë: kishte humbur çdo shpresë se do të shpëtonim.

Për shumë ditë askush s'kishte ngrënë gjë me gojë të vet. Atëherë Pauli u ngrit në mes e tha: »More burra, është dashur të më kishit dëgjuar e mos ta kishim lëshuar Kretën; i kishim shpëtuar këtij rreziku e dëmi. Por tani po u porosis: merrni zemër se asnjë shpirt i gjallë prej jush nuk do të bilet, përveç anijes. Sonte m'u lajmërua engjëlli i Hyut, të cilit i përkas dhe të cilit i shërbej e më tha: — Mos ki frikë, Paul, para Cezarit duhet të dalësh, dhe, ja, Hyu t'i dhuroi të gjithë ata që lundrojnë me ty! Prandaj, merrni zemër, o vëllezër! Unë i besoj Hyut e s' mund të ndodhë ndrysh, por si më ka thënë. Na duhet patjeter të ndeshemi në një ujëdhesë.«





Anijethyerja

Ishte e katërbëdhjeta natë që na rrahte stuhia andej e këndej nëpër Adriatik, diku rreth mesnate detarët morën me mend se po i afroshim ndonjë tokës. Si hodhën plumbçoren gjetën tridhjetë pashë thellësi; pak më vonë e hodhën rishtas e gjetën pesëmbëdhjetë pashë.

Pasi dronin mos të hasim në shkëmbenj, hodhën katër spiranca prej popës e pritshin me afsh të zbardhë drita. Kur detarët, me mendim të ikin nga anija, ulën sandallin në det, kinse donin të hidhnin spirancat

nga kiçi, Pauli i tha centurionit dhe ushtarëve: »Nëse këta nuk rrinë në anije, ju nuk do të shpëtoni.«

Atëherë ushtarët i prenë konopët e sandallit dhe e lanë të bjerë në det.

Deri para agimit Pauli nxiste të hanë bukë. U thoshte: »Është e katërbëdhjeta ditë që pa farë ushqimi prisni me fëlgrim në zemër e nuk ngrëni gjë. Prandaj u bëj lutje: hani se u vlen për shpëtimin tuaj. Prapë po u siguroj se askujt prej jush asnjë fije floku prej kresë s'do t'i humbasë!«

Si i tha këto, fjalë, mori bukën, u falënderua Hyut në sy të të gjithëve, e theu e zu të hajë. Atëherë të gjithë morën

zemër, morën edhe ata bukë e ngrënë. Të gjithë së bashku, ishin në anije rreth dyqind e gjashtëdhjetë e pesë frymë. Si u shujtuan, zunë ta lehtësojnë anijen duke hedhur drithërat në det.

Kur zbardhi drita, detarët nuk e njohën tokën. Hetuan një gji në breg të rrafshët e vendosën, nëse do të ishte e mundur, ta shtinin atje anijen. I zgjidhën spirancat dhe i lanë në det. Zgjidhën gjithashtu të lidhmet e timonit, e ngrhën velin paranik kah era e u drejtuan drejt bregut. Por hasën në cekinë e anija mbeti në rërë: popja e ngulur, nuk luante vendit, ndërsa kiçin e shkallmonte stuhia e valëve.

Ushtarët menduan atëherë t'i vrasin të burgosurit prej frikës se ndonjëri prej sish, pasi të shpëtojë not, mos të ikë. Por centurioni, duke dashur të shpëtojë Paulin, nuk i la ta çojnë në vend këtë mendim: urdhëroi që ata që dinë not, të kërcejnë të parët në ujë e të dalin në tokë e të tjerët le të shpëtojnë, kush me dërrasë e kush me ndonjë copë të thyer të anijes. Kështu të gjithë dolën në tokë shëndosh e mirë.

Qëndrimi në ishullin e Maltës

Si shpëtuam e morëm vesh se ishulli quhej Maltë. Vendasit na treguan një njerëzi të jashtëzakonshme. Ndezën zjarr dhe na afruan të gjithë rreth tij sepse kishte filluar të bjerë shi e bënte të ftohtë. Pauli mbledhi një krah rrozga e i qiti në zjarr. Kur, ja, prej të nxehti doli një gjarpër dhe iu kap për dore. Kur vendasit panë se si gjapëri i varej për dore, i thanë njëri-tjetrit: »Ky njeri me siguri qenka vrashtar; i shpëtoi detit, por Drejtësia nuk e lë të jetojë!« Pauli e shkundi gjarpërin në zjarr e nuk i ndodhi kurrëfarë së keqje; ata prisnin se menjëherë do të ënjtet e do të bjerë i vdekur, porse, pas një pritjeje të gjatë, panë se atij s'po i ndodhë asgjë e jashtëzakonshme, ndërruan mendim e thoshnin: »Qenka Zot!«

Në rrethinën e atij vendi ishte malli i të parit të ishullit, që quhej Publius. Ai na pranoi e për tri ditë na gostiti me shumë njerëzi. I ati i Publiusit ishte ndër ethe i sëmurë nga dizinteria e ishte në të shtruara. Pauli hyri ke ai, u lut, e bekoj duke vënë duart mbi të dhe e shëroi.

Pas kësaj ngjarjeje vinin edhe të tjerë nga ishulli që ishin të sëmurë dhe u shëronin. Ata atëherë na bënë nderime të shumta e, kur deshëm të nisemi, na siguruan me gjithçka kishim nevojë.

Pas tre muajsh morëm detin me një anije aleksandrine, e cila kishte dimëruar në ishull e kishte për shenjë Dioskurët. Si arritëm në Sirakuzë, aty zumë vend tri ditë. Prej andej, duke lundruar përngjat bregut, arritëm në Regj. Të nesërmen filloi të fryeje shiroku e për dy ditë arritëm në Pocuoli. Prej andej arritëm në Romë.

Vitet e fundit të Paulit

Kur vëllezërit e atij qyteti morën vesh se kemi arritur, na dolën para në tregun e Apiut e te Tri Gjellëtoret. Pauli, kur i pa, iu falënderua Hyut e zemra iu mbush me ngushëllim. Si arritëm në Romë, Paulit iu dha leje të jetojë në banesë më vete bashkë me ushtarin që e ruante.

Pas tri ditësh Pauli i grishi në takim të parët e hebrenjve. Kur erdhën, u tha: »Unë, vëllezër, asgjë s'kam bërë kundër popullit tonë as kundër ligjëve të të parëve e megjithatë, të lidhur në pranga në Jerusaleëm, më dorëzuan romakëve.«

Ata i thanë: »Ne nuk kemi marrë prej Judeje kurrëfarë letre lidhur me ty as prej vëllezërve që erdhën prej andej s' kemi dëgjuar gjë të keqe për ty as s'kanë prurë farë lajmi. Ne dëshirojmë të dëgjojmë prej teje çka ti mendon, sepse për atë sektë dimë vetëm kaq: se gjithkund i kundërshtojnë.«

Pasi bashkë me të e caktuan ditën, shumë vetë erdhën në banesën e tij. Në spjegimin e vet Pauli u dëshmonte Mbretërinë e Hyut e, prej mëngjesit e deri në mbrëmje, u mundua t'ua mbushë mendjen, duke folur mbi Jezusin në bazë të Ligjit të Moisiut e të profetëve. Fjalët e tija disave ua mbushën mendjen, e do të tjerë nuk besuan. Kur ashtu, të pa marrë vesh njëri me tjetrin, po shpërndaheshin, Pauli u tha vetëm edhe këtë fjalë:

»Shpirti Shenjt, nëpër gojë të Isaisë profet, u foli mirë etërve tanë:

Shko ke ai popull e thuaj: mirë do t'ia vëni veshin, por gjë s'do të kuptoni; mirë do të vërojtoni e do të shikoni, por gjë s' do të shihni. Tupitur është në ndjenja zemra e këtij populli, veshët u kanë shurdhuar, sytë u vërbuan, që me sy mos të shohin, me veshë mos të dëgjojnë, që mos të kthehen e unë t'i shëroj.

Dinie, pra, të gjithë: shëlbimi i Hyut u është drejtuar paganëve, ata kanë për ta dëgjuar.«

Pauli qëndroi plot dy vjetë në banesë me pagesë dhe i pranonte të gjithë ata që shkonin ke ai. Predikonte Mbretërinë e Hyut e mësonte me liri të plotë e pa farë pengese gjithsa i përket Jezu Krishtit Zot.

Letrat nga Roma

Gjatë kohës së gjatë të qëndrimit në Romë, Pauli, pasi ishte në burgun hetues, u shkroi shumë letra bashkësive të besim-



tarëve dhe disa personave. Këto letra, që bashkë me të tjerat, gjenden në pjesën e fundit të Besëlidhjes së re, përmbajnë, sikurse edhe letrat e mëparshme, mendime fetare që u përkasin elementeve themelore të besimit të krishterë. Po i biem disa pjesë të zgjedhura prej tyre duke shënuar se kujt i kanë qenë drejtuar.

Armët e fesë

»Kështu këndej forcohuni në Zotin dhe në fuqinë e tij të madhe. Ngjeshuni me

armët e Hyut, që të mund t'u qëndroni për ballë pritave të djallit. Sepse s'keni luftë vetëm kundër gjakut e mishit, por kundër Principatave, kundër Pushteteve, kundër sunduesve të kësaj bote së errtë, kundër shpirtave të këqij të hapësirës qiellore. Prandaj ngjeshni të gjitha armët e Hyut që të mund të qëndroni për ballë në ditën e ligë e, pasi të ngadhënjoni mbi të gjitha, të mbeteni zotërues të fushës. Mëkëmbni, pra, djema! Ngjeshni ijet me të vërtetën e në vend të pancirës veshne drejtësinë. Mbathni këmbët me zellin e kumtimit të Ungjillit të paqës! Në çdogjë kinie ngjat vetes fenë në vend të mburojës: me të do të mund t'i fikni shigjetat e zjarrta të të Keqit. Merrni përkrenaren e shëlbimit e shpatën e Shpirtit Shenjt që është Fjala e Hyut!»

Të jeni të gatshëm

»Së fundi, vëllezër, mundohuni të keni për zemër gjithçka është e vërtetë, gjithçka është e ndershme, gjithçka është e drejtë, gjithçka është e pastër, gjithçka është e shenjtë, gjithçka është e denjë për dashuri, gjithçka është e denjë për lavdi, gjithçka është virtut! Çka keni mësuar, çka keni marrë e çka keni dëgjuar e parë në mua — atë bënien dhe Hyu që jep paqën do të jetë me ju!»

Kërkoni çka është lart

»Nëse, pra, jeni ngjallur bashkë me Krishtin, kërkoni çka është lart, ku gjendet Krishti ndenjuri në fron në të djathtën e Hyut! Dëshironi gjërat që janë lart e jo këto përmbi tokë! Sepse keni vdekur e jeta e juaj është e fshehur me Krishtin në Hyun.«

Një letër të shkurtër të drejtuar Filemonit, mikut të vet të vjetër dhe udhëheqësit të krishterëve në Kolos, Pauli i bën lutje ta pranojë një skllav që i kishte ikur e të cilin e kishte kthyer në krishterim Pauli. (Filemonit 15—20)

»Ndoshta shi për këtë punë që ndarë për pak kohë, që të kthehej te ti për amshim, jo më si skllav, por shumë më tepër se skllav, pors vëlla i dashur, sidomos për mua e aq më tepër për ty, qoftë si njeri qoftë si vëlla në Zotin.

Në qoftë se, pra, më mba për shok në fe, pranoje pors mua! E në qoftë se të ka bërë ndonjë padrejtësi ose të ka gjë borxh, më detyro mua për të gjitha.

Po nënshkruhem me dorën time, unë Pauli: unë do të paguaj. Nuk po të përkujtoj se edhe ti ma ke një borxh — shi vetveten! — Po, o vëlla, ma bëj këtë nderë në Zotin: ma kërthnes zemrën time në Krishtin!»

Feja e palëkundshme

—I drejti im do të jetojë prej fesë, por, nëse tërhiqet, shpirti im nuk do të kënaqet më në të.

»E ne veç nuk jemi asish që tërhiqen prapa për t'u bjerrë, por asish që besojnë për t'u shëlbuar.

E feja është një mënyrë pasjeje të atyre sendeve që shpresohen, mjet të njihen sendet që nuk shihen. Në saje të saj të parët tanë fituan dëshminë hyjnore.

Me anë të fesë dimë se bota ka qenë rregulluar në saje të fjalës së Hyut kështu që çka shihet nuk që bërë nga ato që shihen.«



Çfarë ngjau me Paulin pas atyre dy viteve që qëndroi në Romë — nuk dihet. Veprat e Apostujve që na njoftojnë me udhëtimet e tija misionare marrin fund me lajmin se Pauli priste në Romë procesin e gjyqit. Ka shkencëtarë që pohojnë se ai që çliruar dhe se e lëshoi Romën. Megjithatë shumica e madhe janë të mendimit se në kohën e salvimit të Neronit që në Romë dhe aty që vvarë.

Në Letrën e Dytë drejtuar Timoteut, bashkëpunëtorit të vjetër dhe shokut besnik, shihet se Pauli priste vdekjen dhe se mburrej për veprën e vet të kryer për Krishtin.

»Po të përbej para Hyut dhe para Krishtit Jezus, i cili do të gjykojë të gjallët e të vdekurit, pash ardhjen e tij e Mbretërinë e tij: predikojë fjalën, nxit në rast të volitshëm dhe në rast të pavolitshëm,

këshillo, qorto, urdhëro me plot duresë e mësim. Sepse do të vijë koha, kur njerëzit nuk do ta durojnë mësimin e shëndoshë, por, simbas ëndjeve të veta, do të bashkojnë rreth vetes mësues për të kënaqur veshin; veshët do t'i largojnë prej së vërtetës e do t'i sjellin drejt përrallave. Ti veç rri zgjuar me kujdes në çdogjë, duroj të vështirat, kryeje mirë detyrën e Ungjilltarit, kryeje plotësisht shërbesën tënde!

E unë tashmë po e derdhi gjakun tim në nderë të Hyut e koha të nisem për atë jetë ka arritur. Luftën e mirë e luftova, vrapin e kreu, fenë e ruajta. Që tani më pret kurora e drejtësisë, të cilën Zoti, Gjykatësi i drejtë, do të ma japë në atë ditë; e jo vetëm mua, por të gjithë atyre që do ta presin me dashuri Ardhjen e tij të dytë.

Zoti qoftë me shpirtin tënd!
Hiri qoftë me ju!»

Letrat e Pjetrit

Faqet e fundit të Besëlidhjes së re janë të shkruara në kohën dhe pas salvimit që romakët i bënë Kishës së parë. Ato na përkujtojnë lumturinë e ardhshme si shpërblim për vuajtjet e tanishme dhe japin zemër të luftohen ligshtitët shpirtërore. Në këto faqe po biem do pjesë të zgjedhura të Letrave të tjerëve prisa të bashkësive kristiane ndër të cilat edhe ato të shën Pjetrit.

»Në marrëdhënie njëri me tjetrin, veshnu me përvujtni, sepse — Hyu u kundërshton madhështorëve e të përvujtëve u jep hirin.»

Përlunni, pra, nën të pushtetshmen dorën e Hyut, që në kohën e duhur t'ju lartësojë e lëshonia atij në dorë të gjitha kujdeset tuaja, sepse Ai kujdesohet për ju.

Jini të përkurmë e rriini zgjuar. Armiku juaj, djalli, porsi luan uluritës, endet këndej-andej duke kërkuar kë të përpijë. Kundërshtoni të fortë në fe duke e ditur se po të njëjtat vuajtje i pësojnë vëllezërit tuaj në fe të shpërndarë nëpër botë.«

Ardhja e dytë e Krishtit

»Por një gjë, fort të dashur, s'bën mos ta dini: se te Zoti një ditë është si një mijë vjetë po edhe një mijë vjetë si një ditë e vetme. Nuk vonon Zoti ta çojë në vend premtimin si disa e mendojnë të ngadalshëm, por është i durueshëm me ju, pse nuk do që ndokush të birit, por përkundrazi do që gjithkush ta ketë mundësinë të kthehet. Dita e Zotit do të vijë porsi vjen vjedhësi, në të cilën qiejtë do të zhduken me krizmë, elementet do të shkrihen prej të nxehtit e toka me çka ka do të shkatërrohet.

Porse ne presim, sipas premtimit të tij, qiejtë e rinj e tokën e re, ku banon drejtësia.

Këndej, o të dashur, ju, duke pritur këto, mundohuni të jini para tij të panjollë, të patëmetë, në paqë. Po edhe duresën e Zotit çmone shëlbim, sikurse edhe Pauli, vëllai ynë i dashur, u ka shkruar me atë dije që i qe dhuruar. Kështu ai thotë në të gjitha Letrat, ku flet për këtë çështje. Në to, vërtet, ka nga diçka që merret vesh vështirë, çka të padishmit e të paqëndrueshmit e shtrembërojnë, si bëjnë edhe me pjesët e tjera të Shkrimit shenjt — në bjerrje të vetvetes.

E ju, pra, o të dashur, pasi jeni të porositur që më parë për këto, ruhuni, që, të marrë mendsh nga gabimi i të mbrapshtëve mos ta humbni sigurinë e fesë. Por rrituni në hir e në njohje të Zotit tonë dhe Jezu Krishtit Shëlbues.

Atij i qoftë lavdi që tani e deri në ditë të amshimit. Amen!«

Zbulesa e Gjonit

Libri i fundit i Biblës, i shkruar rreth vitit 95 pas Krishtit, Zbulesa e Gjonit, hap një pamje të madhërueshme me parafytyrime të larmishme dhe na paraqet Ardhjen e dytë të Krishtit dhe Gjyqin e fundit të Hyut.

Libri na paraqet kohën e tashme dhe të ardhshmen në trajtë të vegimeve. Por në shumë profeci të Gjonit janë të fshehura sulmet që Gjoni bën kundër Romës — superfuqisë së shekullit të parë: si fjala vjen — aluzionet kundër Babilonisë. Babilonia e vjetër — kryeqyteti i paganëve, leht mund të krahasohej në sytë e të krishterëve të parë me Romën e ditëve të tyre. Këndej shumë të krishterëve u ka dhënë guxim e qëndresë pohimi në vende të ndryshme të tekstit të Zbulesës se: në mbarimin e historisë nuk do të dalë fitues perandori romak, por Krishti!

Pastaj pashë një engjell tjetër që po zbriste nga qielli e kishte pushtet të madh e mbarë toka shndriti nga shkëlqimi i tij. Ai bërtiti me zë të fortë: »Ra, ra Babilonia e Madhe, u bë banesë e djemërve, strofull i shpirtëve të ndytë, i të gjithë shpendëve të ndytë e të urrejtur, sepse me verën

e hidhërimit të fëlligshtisë së saj u dehën popujt mbarë, me të bënë fëlligshti mbarë mbretërit e tokës e tregtarët e dheut u pasuruan prej luksit të pamasë të saj!«


Dëgjova edhe një zë të tjetër që thoshte nga qielli: — Dilni prej saj, populli im, që mos të bëheni pjesëtarë në mëkate të saja! Që mos fu gjejnë të këqiat e saja! Sepse krejtësisht do të digjet ne zjarr, sepse është i pushtetshëm Zoti Hy, që e ka dënuar!«


Qielli i ri — toka e re

Atëherë pashë një qiell të ri e një tokë të re, sepse qielli i parë e toka e parë u zhdukën, as deti s'është më.

Pashë edhe qytetin shenjt — Jerusalemin e ri: zbriste nga qielli, prej Hyut, i stolitur porsi nusja e bërë gati për fatin e vet.

Atëherë dëgjova një zë të fortë që vinte nga froni: »Ja, banesa e Hyut me njerëz! Hyu do të banojë me njerëz, ata do të jenë populli i tij e ai do të jetë Hyu me ta: ai do të fshijë çdo lot nga sytë e tyre! As vdekje më s'do të ketë, as vaj, as ofshame as dhimba më s'do të





ketë, sepse bota e mëparshme mori fund.
Atëherë ai që rri në fron tha: »Ja, unë
bëj çdogjë të re!«

E më kaloi — në shpirt — në maje
të një mali të madh e të lartë, dhe më
tregoi qytetin shenjt, Jerusalemin: po zbriste
nga qielli, prej Hyut; shkëlqente nga Lavdia
e Hyut: i shndritshëm porsi guri i paç-
mueshëm, porsi guri jaspis, kristalor. Rreth
e rreth me mure të mëdha e të larta;
kishte dymbëdhjetë dyer e në dyer dymbë-
dhjetë engjëj dhe të shkruar emrat e dym-
bëdhjetë fiseve të të bijve të Izraelit.

FUND

Në qytet nuk pashë Tempull: sepse Tem-
pulli i tij është Zoti Hy, i Gjithpushtet-
shmi, Qengji. Qyteti s'ka nevojë për diell
as për hënë për t'u shndritur, sepse e ndr-
çon Lavdia e Hyut, ndërsa llamba e tij
është Qengji. Popujt do të ecin në dritën
e tij e mbretërit e tokës në të do ta sjellin
lavdinë e vet. Dyert e tija nuk do të
mbyllen gjatë ditës — e natë aty s'do të
ketë më. Në të s'do të hyjë asgjë që mos të
jetë e pastër, as ai që bën punë të liga
ose gënjen: por vetëm ata që janë të shkruar
në librin e Jetës së Qengjit.